

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5464
E hënë, 30 prill 2018
çmimi 0.40 €

Ministri Reçica: Serbia po pengon Kosovën në rrugën e integritimit

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

META: SHQIPTARËT JANË FAKTORË TË RËNDËSISHËM NË MAQEDONI F. 2

NITAJ: ZGJEDHJET, PAS KATËR VJETËSH F. 6

QEVERIA NUK PËRGJIGJET NË LIDHJE ME DRAFTLIGJIN PËR FSK-në F. 5

KATËR VETËVRASJE PËR TRE MUAJ F. 7

EKONOMI

GASHI KËRKON TË JETËSOHET IDEJA PËR THEMELIMIN E BANKËS SË DIASPORËS F. 8

KULTURË

MINISTRI GASHI VIZITON YMCA NË SHBA F. 13

SPORT

ÇLIRIM LEPAJA, 'INIESTA' I KOSOVËS F. 16

DRITA DHE PRISHTINA NUK GABOJNË, VAZHDON GARA PËR TITULL F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAQIR TOTAJ ■ FAQE 4-5

Kam përkrahje që ta udhëheq PDK-në në Prizren



Ish-kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të Prizrenit, Shaqir Totaj, synon ta udhëheqë këtë parti në këtë komunë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Totaj ka treguar se brenda anëtarësisë së PDK-së ka disponim të madh që në zgjedhjet e brendshme ta bëjnë atë kryetar. Totaj ka thënë se për fuqizimin e PDK-së në këtë komunë është duke punuar shumë, pasi po i sjell kësaj partie njerëz me profesione të ndryshme që nuk kanë qenë më parë pjesë e PDK-së. Në këtë intervistë Totaj ka folur edhe për qeverisjen e Mytahir Haskukës në Prizren. Ai ka thënë se qeverisja që po bëhet në këtë komunë nuk është diçka me të cilën mund të krenohet Haskuka dhe as Lëvizja Vetëvendosje

Vazhdojnë kërkimet për gjetjen e dy policëve të zhdukur në lumin Lepenc

Dy policë të Kosovës kanë rënë në rrjedhën e lumit Lepenc në aksidentin e ndodhur në rrugën magjistrale Hani i Elezit - Kaçanik, te vendi i quajtur "Kulla me çezmë". Policia ka bërë me dije se për shkaqe ende të panjohura, vetura në të cilën gjendeshin dy policët kishte humbur kontrollin nga rruga duke rënë nga një lartësi në rrjedhën e lumit Lepenc. Kërkimet për gjetjen e dy policëve kanë vazhduar edhe të dielën brenda territorit të Kosovës dhe pesë kilometra në brendi të territorit të Maqedonisë, me ç'rast ekipet kanë arritur ta gjejnë dhe ta nxjerrin nga lumi vetëm veturën e aksidentuar ■ FAQE 8-9



Duhet të ketë më shumë investime të partneritetit publiko-privat



Drejtori i D&D Business Support Center, Safet Fazliu, i cili më parë ishte edhe drejtor i Agjencisë për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme në kuadër të MTI-së, ka

thënë se në Kosovë duhet të aplikohet modeli i Partneritetit Publiko-Privat (PPP) sa iu përket investimeve në resorët e mëdhenj. Ai në një bisedë për gazetën "Epoka e re" ka thënë se ka ini-

ciativa të pakta në investime përmes PPP-ve. Fazliu ka pohuar se vendi ynë ka potenciale dhe mundësi të shumta për shtimin e investimeve përmes PPP-ve, në veçanti në nivelin lokal ■ FAQE 8-9

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat.styro@yubikon.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kuvendi Kombëtar i PD-së miraton Statutin e ri

TIRANË, 29 PRILL - Partia Demokratike zhvilloi të dielën mbledhjen e Kuvendit Kombëtar, që zgjati përreth pesë orë, duke përfunduar me miratimin e Statutit të ri, që duhet thënë se blinda pozitat e Lulzim Bashës në krye të saj. Në këtë Kuvend mungonin kritikët kryesorë si Astrit Patozi, Jozefina Topalli dhe Majlinda Bregu, ndërsa të pranishëm ishin vetëm disa prej zërave kundër, si Besnik Mustafaj, Tomorr Alizoti,

Eduard Selami dhe Edit Harxhi. Në hapje të Kuvendit u vendos theksi te keqqueverisja e kryeministrit Edi Rama, ndërkohë që në vijim pati kundërshti nga Gent Malko dhe Euard Selami. Selami i bëri thirrje Bashës të rrezojë këtë statut, pasi është më i keqi në histori dhe do ta "fundosë" Partinë Demokratike, ndërsa theksoi se problemi i partisë është mungesa e demokracisë së brendshme. Pavarësisht prej

përplasjeve, Statuti u miratua dhe kështu Partia Demokratike do të nisë një proces rristurimi të thellë në bazë, nga seksionet e deri te kryetarët. Midis ndryshimeve të reja është edhe një nen që cakton kryetar për Këshillin Kombëtar që deri më tani, ishte në varësinë e kryetarit të partisë. Pas zgjedhjeve në të gjitha degët e saj në vjeshtë, Partia Demokratike do ta mbledhë Kuvendin Zgjedhor për t'i votuar organet drejtuese të saj.



Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, zhvilloi një vizitë në komunën e Strugës

Meta: Shqiptarët janë faktorë të rëndësishëm në Maqedoni

Gjatë vizitës në Komunën e Strugës, presidenti Ilir Meta tha se shqiptarët në Maqedoni janë faktorë të rëndësishëm dhe fatmirësisht pozitivë për stabilitet, për integrimin evropian për anëtarësim në NATO

STRUGË, 29 PRILL - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, zhvilloi një vizitë në Strugë, ku u prit në mënyrë të ngrohtë e vëllazërore nga kryetari i Komunës së Strugës, Ramiz Merko, këshilltarët e komunës, përfaqësues të bashkësive fetare, përfaqësues të forcave të ndryshme politike dhe qindra banorë të qytetit. Gjatë takimit të përzemërt që pati në ambientet e Komunës së Strugës, presidenti Meta bashkëbisedoi me kryetarin e komunës dhe këshilltarët rreth rolit të shqiptarëve në Maqedoni, por edhe për momentin e rëndësishëm që po kalojnë të dy vendet në aspektin e integritimit evropian, perspektivën e shkëlqyer të Strugës, për të qenë një qendër

rajonale e zhvilluar turistike, kulturore dhe ekonomike etj. "Struga është një qytet jashtëzakonisht i veçantë për të gjithë shqiptarët kudo ku janë. Është një nga qytetet tona më të bukura. Është e gjitha një trevë me tradita të jashtëzakonshme patriotike me një rol të fortë në historinë e mbarë kombit, me figura të shquara për pavarësinë e Shqipërisë dhe në vazhdimësi. Vijmë në një moment të mirë, Shqipëria dhe Maqedonia sapo kanë marrë një rekomandim pozitiv nga Komisioni Evropian për çeljen e negociatave dhe duhet t'i forcojmë të gjitha përpjekjet në javët që vijnë për të marrë dhe një vendim pozitiv nga këshilli i vendeve anëtare dhe në qershor", tha presidenti i



Shqipërisë, duke u ndalur edhe zhvillimet në Maqedoni dhe pozitat e shqiptarëve. "Besojmë se në Maqedoni është bërë një progres i rëndësishëm, sidomos gjatë vitit të fundit. Këtë besoj e tregon edhe pozita e shqiptarëve. Për herë të parë kemi një kryetar të parlamentit që është zgjedhur

nga forcat politike shqiptare. Po kështu kemi një vendosmëri të një shumice për ta filluar sa më shpejt zbatimin e Ligjit për gjuhën, që do t'i japë një zgjidhje të munguar deri tani, e që nuk është një privilegj që i bëhet popullit shqiptar, por një detyrim, është një domosdoshmëri. Përveç të tjerash, besoj se

edhe zgjidhja e emrit është më pranë se asnjëherë tjetër me Greqinë, gjë që do ta ndihmojë Maqedoninë të ketë një frymëmarrje tjetër në të gjitha proceset, jo vetëm të anëtarësimit në NATO, të çeljes së negociatave me BE-në, por edhe një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik. Ky është një interes i madh edhe i Shqipërisë, sepse Maqedonia është një vend fqinj, por jo vetëm kaq. Edhe për arsye se shqiptarët këtu janë faktorë të rëndësishëm dhe pozitivë për stabilitet, për integrimin evropian për anëtarësim në NATO. Besoj se edhe në nivel vendor është shumë e rëndësishme ta rrisim rolin e komunave në këto shkëmbime", theksoi presidenti Meta.

Pas këtij takimi, presidenti i Shqipërisë zhvilloi edhe një vizitë të shkurtër në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës, ku studiojnë dhe punojnë të rinj nga rajoni dhe nga Shqipëria.

Zaevi: Kontesti me Greqinë zgjidhet me kalimin e sovranitetit në BE

SHKUP, 29 PRILL - Zgjidhja përfundimtare e kontestit rreth emrit me Greqinë mund të arrihet paralelisht me procesin e anëtarësimit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian, kur edhe sovraniteti i shtetit do t'i kalonte Unionit. Kështu shprehet kryeministri Zoran Zaev në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë". Ai thotë se deri në zgjidhjen përfundimtare, dy vendet mund të arrijnë një marrëveshje të përkohshme, apo një komizë për një emër me përcaktim gjeografik, pa prekur në çështjet që

kanë të bëjnë me identitetin. Por kjo, sipas kreut të Qeverisë, duhet të konfirmohet në referendum nga qytetarët e Maqedonisë. "Ndoshta zgjidhja përfundimtare do të jetë e lidhur me votimin e qytetarëve të Maqedonisë, duke i dhënë sovranitetin tonë Bashkimit Evropian, ku dëshirojmë të anëtarësohemi dhe atëherë hapet edhe Kushtetuta. Ndoshta këtu është zgjidhja, për shkak se, siç e dini, Greqia kërkon edhe ndryshimin e Kushtetutës për ndryshimin e emrit kushtetues. Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras

mund t'i shtrijnë duart dhe të arrijnë marrëveshje, por institucionet janë ato të cilat e nxjerrin qëndrimin përfundimtar, sikur edhe qytetarët e të dy vendeve", ka thënë ai. "Për këtë duhet të kujdesemi, duhet të jemi kreativë për gjetjen e zgjidhjes që do t'i kënaqë së paku nevojat minimale të dy vendeve", deklaroi Zaev duke mos fshehur optimizmin e tij që, më në fund, ky kontest prej më se dy dekadash të gjejë zgjidhje, me çfarë do të zhblllokohej procesi i integritetit të Maqedonisë në NATO dhe BE.



Vazhdojnë kërkimet për gjetjen e dy policëve të zhdukur në lumin Lepenc

Dy policë të Kosovës kanë rënë në rrjedhën e lumit Lepenc në aksidentin e ndodhur në rrugën magjistrale Hani i Elezit-Kaçanik, te vendi i quajtur "Kulla me çezmë". Policia ka bërë me dije se për shkaqe ende të panjohura, vetura në të cilën gjendeshin dy policët kishte humbur kontrollin nga rruga, duke rënë nga një lartësi në rrjedhën e lumit Lepenc. Kërkimet për gjetjen e dy policëve kanë vazhduar edhe të dielën brenda territorit të Kosovës dhe pesë kilometra në brendi të territorit të Maqedonisë, me ç'rast ekipet kanë arritur të gjejnë dhe ta nxjerrin nga lumi vetëm veturën e aksidentuar

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 29 PRILL - Në rrethana ende të paqarta vetura në të cilën gjendeshin dy policë të Republikës së Kosovës, me iniciallet M. D. dhe A. T., ka rënë në rrjedhën e lumit Lepenc. Policia e Kosovës ka bërë me dije se aksidenti ka ndodhur në mbrëmjen e së shtunës rreth orës 20:45 në rrugën magjistrale Hani i Elezit - Kaçanik, tek vendi i quajtur "Kulla me çezmë". Vetura zyrtare e policisë, në të cilën gjendeshin edhe dy policët, kishte humbur kontrollin dhe kishte dalë nga rruga duke rënë nga një lartësi në rrjedhën e lumit Lepenc. Për gjetjen e dy policëve të zhdukur kërkimet janë duke i vazhduar policia, zjarrfikësit, FSK-ja, KFOR-i, si dhe qytetarët vullnetarë.

Kërkimet për gjetjen e dy zyrtarëve policorë kanë vazhduar edhe të dielën në territorin e

Kosovës dhe pesë kilometra në territorin e Maqedonisë.

Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Refki Suma, ka thënë se FSK-ja nuk mund të dalë në territorin e Maqedonisë pa leje të autoriteteve maqedonase në vendin ku po dyshohet se mund të gjenden trupat e dy policëve. "Policia maqedonase dhe ajo e Kosovës kanë bashkëpunim mes vete. Ata mund të kontrollojnë/patullojnë pesë kilometra në terriore respektive. FSK-ja nuk mund të dalë pa leje të autoriteteve maqedonase në territorin e Maqedonisë në vendin ku po dyshohet se mund të gjenden trupat e dy policëve të humbur mbrëmë pas një aksidenti në magjistralen Kaçanik - Hani i Elezit", ka theksuar Suma.

Por nga kërkimet e deritanishme njësitet përkatëse kanë arritur ta nxjerrin nga Lepenci vetëm veturën e aksidentuar. Ndërkohë, në vendin e ngjarjes të dielën ka



shkuar edhe ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, i shoqëruar nga ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Naim Rexha, dhe shefi i stafit të kryeministrit Haradinaj, Avni Arifi. Gashi, Rexha dhe Arifi janë zotuar se do të angazhohen maksimalisht dhe nuk do të ndalen për asnjë çast për kërkimin e dy zyrtarëve policorë të përfshirë në këtë aksident, të cilët kanë qenë në kryerje të detyrës zyrtare kur ka ndodhur aksidenti. Po ashtu, ata kanë

thënë se ndajnë shqetësimin me familjarë dhe zyrtarë policorë në këtë fazë shumë të vështirë për fatin e dy policëve, të cilët ishin në shërbim të qytetarëve dhe vendit. Për zhdukjen e dy policëve në aksidentin në lumin Lepenc ka reaguar presidenti i vendit, Hashim Thaçi, duke thënë se në këto momente të vështira të pritjes, dhembjes dhe shpresës, është bashkë me anëtarët e familjeve të policëve. Presidenti ka përgëzuar njësitet e FSK-së, të Policisë së Kosovës, zjarrfikësit dhe qytetarët që janë duke kërkuar dy policët. "Në këto momente të vështira të pritjes, dhembjes dhe shpresës jemi bashkë me anëtarët e familjeve të dy policëve, që u aksidentuan në rrugë buzë lumit Lepenc. Përgëzoj njësitet e FSK-së, të Policisë së Kosovës, zjarrfikësit dhe qytetarë të shumtë, të cilët janë duke kërkuar policët që nga orët e para të aksidentit", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se aksidentimi i dy policëve është lajm i dhimbshëm që ka pikëlluar të gjithë. Në këto çaste tejet të rënda e të pritjes në ankth ai ka thënë se bashkëndjen me familjarët e policëve. "Aksidentimi i dy policëve tanë, në afërsi të lumit Lepenc, është një lajm i dhimb-

shëm që i ka pikëlluar të gjithë. Jemi me familjet e tyre, në këto çaste tejet të rënda e të pritjes në ankth. Falënderoj FSK-në, Policinë e Kosovës, zjarrfikësit, si dhe të gjithë ata që prej mbrëmë janë në kërkim të dy policëve", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se është shumë pikëllues lajmi për zhdukjen e dy policëve të Kosovës në lumin Lepenc. Ai ka theksuar se ngjarjet si kjo na bëjnë të mos harrojmë kurrë se Policia e Kosovës është ajo që me shumë mund dhe shpesh dhe sakrificë kujdeset për një ambient të sigurt. "Është shumë pikëllues lajmi për zhdukjen e dy policëve të Kosovës në lumin Lepenc. Ndaj shqetësimin me familjarët dhe miqtë në këtë fazë shumë të vështirë të shpresës dhe frikës për fatin e policëve tanë. Ngjarjet si kjo na bëjnë të mos harrojmë kurrë se Policia e Kosovës është ajo që me shumë mund dhe shpesh dhe sakrificë kujdeset që ne të jetojmë në ambient të sigurt. Falënderoj të gjitha njësitet relevante, Policinë e Kosovës, FSK-në, zjarrfikësit dhe të gjithë të përfshirët në kërkim të dy policëve tanë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



17 policë humbën jetën që nga themelimi i Policisë së Kosovës

PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Sindikata e Policisë së Kosovës ka reaguar lidhur me rastin e së shtunës, ku dy zyrtarë policorë kanë pësuar një aksident në rrugën Hani i Elezit-Kaçanik, duke rënë në lumin Lepenc dhe të cilët ende nuk

janë gjetur. "Rasti i mbrëmshëm i fatkeqësisë, me ç'rast ende nuk dihet për fatin e dy zyrtarëve policorë, na ka tronditur dhe shqetësuar shumë. Këtë dhimbje dhe shqetësim jemi duke e bashkëndjerë me familjarët,

me të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës dhe qytetarët e vendit tonë", është thënë në reagimin e kësaj sindikate.

Sindikata e Policisë së Kosovës ka bërë me dije se 17 policë kanë humbur jetën që nga

themelimi i Policisë së Kosovës. "Edhe ky rast i rëndë dhe i dhimbshëm, ku ende nuk dihet për fatin e dy zyrtarëve policorë që nga mbrëmë, por edhe rastet e deritashme të punonjësve të rënë në detyrë e që janë 17 deri

më tani, janë dëshmi se urgjentisht dhe pa humbur kohë institucionet e vendit duhet ta zgjidhin këtë çështje kruciale-jetike për punonjësit e Policisë së Kosovës", është thënë në reagimin e Sindikatës së Policisë së Kosovës.

Flet për "Epokën e re", Shaqir Totaj

Kam përkrahje që ta udh



Ish-kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të Prizrenit, Shaqir Totaj, synon ta udhëheqë këtë parti në këtë komunë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Totaj ka treguar se brenda anëtarësisë së PDK-së ka disponim të madh që në zgjedhjet e brendshme ta bëjnë atë kryetar. Totaj ka thënë se për fuqizimin e PDK-së në këtë komunë është duke punuar shumë, pasi po i sjell kësaj partie njerëz me profesione të ndryshme që nuk kanë qenë më parë pjesë e PDK-së. Në këtë intervistë Totaj ka folur edhe për qeverisjen e Mytaher Haskukës në Prizren. Ai ka thënë se qeverisja që po bëhet në këtë komunë nuk është diçka me të cilën mund të krenohet Haskuka dhe as Lëvizja Vetëvendosje

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 29 PRILL - Ish-kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të Prizrenit, Shaqir Totaj, ka bërë me dije se ka për synim të bëhet kryetar i degës së këtij subjekti politik në këtë komunë. Ai ka deklaruar se për këtë ka një disponim të madh të anëtarësisë së PDK-së në Prizren. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e

re", Totaj ka vlerësuar se me zgjedhjen e tij do të fuqizohet kjo degë e PDK-së. "Po, do të konkurroj për kryetar të Degës së PDK-së në Prizren. Është një disponim pozitiv i elektoratit të PDK-së që të jem kryetar i kësaj dege. Këtë disponim qytetarët e Prizrenit e kanë treguar edhe në zgjedhjet e fundit lokale. Tani besoj se është një rast i mirë që ky disponim, kjo përkrahje që gëzoj, të konfirmohet nga anëtarësia e PDK-së", ka thënë Totaj. Ai ka treguar

se në procesin e brendshëm zgjedhor të PDK-së po ofron kuadro të reja. "Unë kam pasur kontakte me shumë njerëz, të cilët nuk kanë qenë anëtarë të PDK-së. Ata janë njerëz profesionist, ekspertë të fushave të ndryshme. Tani ata kanë treguar interesim që të inkuadrohen në këtë proces duke shpresuar se PDK-ja do ta vazhdojë rrugën e vet drejt reformave që kanë filluar", ka thënë Totaj. Ai është shprehur i bindur se

reformat në këtë parti nuk do të jenë vetëm fjalë. "Për këtë arsye ne vazhdimisht jemi në kontakt me njerëz të cilat kanë shprehur gatishmëri të inkuadrohen dhe ta japin kontributin e tyre në këtë subjekt politik. Njëkohësisht, ne do ta ruajmë edhe bërthamën e PDK-së, sepse kjo parti në Prizren ka një strukturë, një organizim të madh që prej vitesh ka dhënë kontribut në PDK. Kështu që, në të ardhmen do ta kemi një kombinim në mes të anëtarëve të dëshmuar të PDK-së dhe figurave të reja që do të inkuadrohen tani përmes procesit të brendshëm zgjedhor", ka thënë Totaj, duke shtuar se kjo do ta ndihmojë PDK-në dhe ta përgatisë ballafaqimin me sfidat e reja të kohës.

Në këtë intervistë Totaj ka folur edhe për përmendjen e emrit të tij për ministër të ri të Inovacionit të Ndërmarrësisë dhe për qeverisjen lokale në qytetin e Prizrenit.

"Epoka e re": Z. Totaj, me shpalljen e zgjedhjeve të brendshme në Partinë Demokratike të Kosovës jeni treguar mjaft aktiv në aktivitetet partiake në Prizren. Si po ecën ky proces në degën tuaj?

Totaj: Procesi i brendshëm zgjedhor ka filluar me Rininë Demokratike dhe si i tillë do të jetë një proces transparent dhe shumë kualitativ. Ky është një proces i cili simbolizon fillimin e 'Dekadës së Re' dhe besoj se në përfundim të tij do të dalim me kuadro të reja, me një orientim programor dhe kualitativ, i cili do t'i përmbushë objektivat e PDK-së që janë shtetformuese.

"Epoka e re": A do të inkuadroheni ju personalisht në këtë proces?

Totaj: Pas përfundimit të zgjedhjeve, në kuadër të Rinisë Demokratike të Kosovës dhe të Forumit të Gruas Demokratike,

ëheq PDK-në në Prizren

priten zgjedhjet e ekipit të seniorëve. Po them kështu meqenëse jam njëfarë sportisti. Natyrisht se do të inkuadrohem në këtë proces dhe të shohim më tutje se çfarë do të ndodhë.

"Epoka e re": Inkuadrimi juaj nënkupton se do të kandidoni për kryetar të Degës së PDK-së në Prizren?

Totaj: Po, do të konkurroj për kryetar të Degës së PDK-së në Prizren. Është një disponim pozitiv i elektoratit të PDK-së që të jem kryetar i kësaj dege. Këtë disponim qytetarët e Prizrenit e kanë treguar edhe në zgjedhjet e fundit lokale. Tani besoj se është një rast i mirë që ky disponim, kjo përkrahje që gëzoj, të konfirmohet nga anëtarësia e PDK-së.

"Epoka e re": Meqenëse ju jeni identifikuar si figurë e re e PDK-së, me zgjedhjen tuaj në krye të kësaj dege, sa do të arrini të tërhiqni kuadro të reja?

Totaj: Unë kam pasur kontakte me shumë njerëz, të cilët nuk kanë qenë anëtarë të PDK-së. Ata janë njerëz profesioni, ekspertë të fushave të ndryshme. Tani ata kanë treguar interesim që të inkuadrohen në këtë proces duke shpresuar se PDK-ja do ta vazhdojë rrugën e vet drejt reformave që kanë filluar.

Jam i bindur se reformat nuk do të jenë vetëm fjalë, ato do të ndodhin në realitet.

Për këtë arsye ne vazhdimisht jemi në kontakt me njerëz të

cilat kanë shprehur gatishmëri të inkuadrohen dhe ta japin kontributin e tyre në këtë subjekt politik. Njëkohësisht, do ta ruajmë edhe bërthamën e PDK-së, sepse kjo parti në Prizren ka një strukturë, një organizim të madh që prej vitesh ka dhënë kontribut në PDK. Kështu që, në të ardhmen do ta kemi një kombinim në mes të anëtarëve të dëshmuar të PDK-së dhe figurave të reja që do të inkuadrohen tani përmes procesit të brendshëm zgjedhor. Kjo do ta ndihmojë PDK-në, do ta përgatisë në ballafaqimin me sfidat e reja të kohës që kërkojnë profile të ndryshme profesionale.

"Epoka e re": Zgjedhjet e brendshme, sa do ta konsolidojnë PDK-në në përgjithësi?

Totaj: Besoj shumë se zgjedhjet e brendshme do të kenë ndikim pozitiv në drejtim të konsolidimit dhe të reformimit të partisë. Po ndodh një frymë e re, sepse kemi hyrë në 'Dekadën e Re', dhe ka një gatishmëri e vullnet për të ecur përpara. Besoj se me këtë punë nuk do të mungojë as rezultati.

"Epoka e re": Cili është vlerësimi juaj për qeverisjen në Komunën e Prizrenit?

Totaj: Qeveria në këtë komunë nuk është diçka me të cilën mund të krenohet kryetari aktual i Prizrenit dhe as Lëvizja Vetëvendosje që ka fituar këtë komunë. Prej ditës së parë shumë gjëra nuk kanë shkuar si duhet. Emërimi i drejtorëve të

rinj dhe disa procese të tjera nuk kanë shkuar në rregull. Janë larguar shumë prej premtimeve elektorale dhe nuk po vërehet ndonjë kualitet i ri, për të cilin ata kanë luftuar. Qeverisja aktuale ende vazhdon ta kritikojë qeverisjen e kaluar dhe të ankohet se ka shumë probleme. Qeverisë aktuale në këtë komunë i mungojnë vizioni i qartë dhe gatishmëria që të adresohen sfidat e problemet që ekzistojnë në Prizren.

"Epoka e re": Do të thotë, qytetarët e kësaj komune i kanë rënë pishman që nuk ju kanë zgjedhur juve kryetar?

Totaj: Kjo është vështirë të konstatohet por, në kontakte me qytetarë, kam pasur shumë raste që kanë treguar njëfarë pendimi se kanë gabuar me votën e tyre. Mirëpo, ajo që vërehet është se qeveria aktuale në Prizren nuk po arrin t'i përmbushë premtimet elektorale deri më tani.

"Epoka e re": Z. Totaj, emri juaj është përfolur në medie për ministër të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

Totaj: Me kryetarin e partisë, z. Veseli, kemi kontakte të vazhdueshme dhe bisedojmë për planifikimin e temave të ndryshme, përveç të tjerash, edhe të karrierës time. Kemi pasur bisedime, mirëpo asgjë nuk ka të konfirmuar. Në këtë moment nuk mund të flas më tepër për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të bisedës dhe për shkak se kjo është një temë e ndjeshme. Nëse ka diçka konkrete, do të jem i gatshëm të bisedoj.

Qeveria nuk përgjigjet në lidhje me draftligjin për FSK-në

PRISHTINË, 29 PRILL - Nuk dihet ende nëse do të procedohet sot (e hënë) ashtu siç ishte paralajmëruar, draftligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) për miratim në Qeveri. Paralajmërimin për dërgimin në Qeveri të këtij draftligji e kishte bërë Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) përmes drejtorit për informim në këtë ministri, Ibrahim Shala. "MFSK-ja është duke kryer aktivitetet dhe obligimet e veta sipas planit legjislativ të Qeverisë. Aktualisht jemi në pritje të deklaratës financiare për koston buxhetore nga Ministria e Financave si dhe pëlqimin nga Ministria e Integritimit Evropian në

mënyrë që draftligjet të jenë të harmonizuara me legjislacionin e BE-së. Ne në përputhje me Strategjinë Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të Planit Veprues të MFSK-së, deri më 30 prill do ta dërgojmë draftligjin në Qeveri", kishte deklaruar për media Ibrahim Shala, drejtor i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun në MFSK. Megjithatë, të dielën asnjëra nga tri ministritë e përmendura nga Shala, MFSK-ja, MF-ja dhe MIE, nuk janë përgjigjur në pyetjet e drejtuara nga "KosovaPress", nëse rekomandimet janë dhënë dhe nëse draftligji do të dërgohet për miratim në Qeveri këtë të hënë.



Nitaj: Zgjedhjet, pas katër vjetësh

PRISHTINË, 29 PRILL - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, është tallur me parashikimet e zëvendësit të Ramush Haradinajt në Qeveri, Behgjet Pacollit, se vitin e ardhshëm do të ketë zgjedhje. Nitaj ka thënë se lideri i AKR-së ka hyrë në fushën e Nostradamusit. "Këto parashikime janë në sferën e

'Nostradamusit'! Duhet me qenë tepër i 'mbërrimë' që të parashikosh se kur do të ketë zgjedhje. Ato mund të ndodhin edhe vitin e ardhshëm, edhe pas katër vjetësh. Kush e di", ka thënë Nitaj për "Express". Ai ka thënë se Qeveria është duke e vazhduar punën e vet. "Unë vlerësoj se Qeveria është duke kryer punët e veta, pavarësisht se formalisht ka

më pak vota sesa do të duhej. Ju kujtoj se Qeveria është duke kaluar ligje edhe me dy të tretat e votave dhe ka një klimë bukur bashkëpunuese në Kuvend. Kjo një. Dhe, e dyta, nuk është shumë e qartë nëse Qeveria i ka 52 vota, siç është formalisht, apo 62. Unë vlerësoj se Lista Serbe ende është pjesë e Qeverisë", ka thënë Nitaj.



Fshati i lotëve



GJAKOVË, 29 PRILL - Hydajete Binakaj nga fshati Korenicë, i cili gjendet në rrethinën e Gjakovës, nuk e ka parë burrin e vet Selman Binakaj që nga data 27 prill i vitit 1999. Në këtë ditë ka ndodhur masakra e Mejës, në të cilën janë vrarë 376 persona. "Krejt të fshatit janë gjetur, vetëm burri im dhe një komshi këtu ende jo", ka treguar ajo. Binakaj thotë se nuk mund ta paramendojë ditën e 27 prillit. Ajo ka treguar se atë ditë e gjithë familja ishte në shtëpi, në momentin kur forcat serbe hynë brenda. "Më 27 prill 1999 ka qenë tmerr. Unë nuk mund ta paramendoj atë ditë.

Tmerrohem sa herë që e kujtoj. Kemi qenë gjithë familja këtu, në këtë vend ku po rrimë. Kanë hyrë brenda policët serbë. Burri, kunati, pleqtë, i kam pas dy vjehrrit, kunata me fëmijë dhe na kanë dëbuar. Shpejt, shpejt jashtë! Në atë gjuhën e tyre. Nuk kam gojë me e fol atë gjuhën e tyre". Momentin e ndarjes nga burri, Hydajete Binakaj e përshkruan me shumë emocione dhe me lot në sy. Ajo tregon se burri i saj mbante në krahë djalin e tyre, i cili është me të meta mentale. Hydajetja është nënë e tre fëmijëve, dy djemve binjakë dhe një vajze. Njërin djalë e ka në Institutin Psikiatrik në Shtime.

Djali tjetër, i cili jeton me të, ka probleme me dëgjim. Vajza 20-vjeçare është studente. Ajo përballat me shumë vështirësi financiare. Të dy fëmijët dhe veten i mban me pension të burrit të pagjetur, i cili është 170 euro. "Unë e mbaj familjen. Unë as nuk jam në punë. Me 170 euro të burrit që i marrin të gjithë për martirë, i marr edhe unë", ka treguar ajo. Selim Zymberi nga fshati Molliq i Komunës së Gjakovës ka humbur katër pjesëtarë të familjes së tij, ndër ta, edhe djalin 17 vjeç, Arbërin. Zymberi thotë se djali i tij, Arbëri, ishte në vitin e tretë të shkollës së mesme. Ai është vrarë tri ditë pasi kishte

mbushur 17 vjet. Ditën kur ka ndodhur masakra, Selim Zymberi tregon se djali i tij, Arbëri, nuk ka qenë me të, pasi kishte shkuar në fshatin Dobrosh në Komunë të Gjakovës me axhën e vet, djalin e axhës dhe gjyshen. Ata menduan se kështu po strehoheshin nga forcat serbe dhe do të shpëtonin. "Ngjarja e Mejës është një ndër ngjarjet më kobzeza për Kosovën. Motivet janë shumë të ndryshme se pse ka ndodhur ajo ngjarje pikërisht në Mejë. Koha e luftës ishte ajo që i deportonte njerëzit prej fshatrave të ndryshme dhe i grumbullonte në llogore të caktuara që zakonisht i konvenonte

pushtetit serb. E ata njerëz gjithmonë kanë qenë si viktimat të cilat do t'i shërbenin armikut për t'u hakmarrë ndaj njerëzve tanë të cilët ishin të pafajshëm dhe të paarmatosur", ka thënë Zymberi.

Trupat e pagjetë të katër pjesëtarëve të familjes Zymberi janë gjetur dhe varrosur në vitin 2003. Masakra e fshatit Mejë, që gjendet në rrethinë të Komunës së Gjakovës, ka ndodhur më 27 prill të vitit 1999. Në këtë masakër janë vrarë 376 persona. Edhe pas 19 vjetëve të përfundimit të luftës në Kosovë konsiderohen se janë 1 658 persona të pagjetur, shumica prej tyre shqiptarë.

Edhe kjo javë do të jetë me diell

PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka treguar të dhënat për motin për pesë ditët e ardhshme. Sipas IHMK-së, gjatë kësaj periudhe vendi ynë do të vazhdojë të mbetet nën ndikimin e masave të ajrit me presion të

ngritur atmosferik. "Në këto kushte do të mbajë mot i ndryshueshëm me diell dhe vranësira të cilat gjatë javës vende-vende do të sjellin riga lokale të shiut, derisa në fundjavë pritet të ketë reshje të intensitetit mesatar dhe lokalisht të lartë.

Temperaturat minimale do të lëvizin nga 9-11 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihet të lëvizin ndërmjet 24-27 gradë celsius. Do të fryjë erë kryesisht nga juglindja me shpejtësi deri 13m/s", është thënë në njoftimin e IHMK-së.



Reçica: Serbia po pengon Kosovën në rrugën e integrimit

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, i cili po merr pjesë në konferencën ndërkombëtare për leadership në Vjenë, ka theksuar se Serbia jo vetëm se heziton ta njohë Kosovën, por është duke penguar edhe rrugën e saj drejt integrimit. Ai ka thënë se Serbia duhet ta kuptojë se Kosova është shtet i pavarur

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

VJENË, 29 PRILL - Në Ballkanin Perëndimor politikat duhet të drejtohen kah fqinjësia e mirë, zhvillimi ekonomik, largimi i barrierave dhe integrimi në Bashkimin Evropian. Kështu ka deklaruar ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, në konferencën ndërkombëtare për leadership, "Drejt ndërvarësisë dhe prosperitetit të përbashkët: roli i liderëve fetarë dhe parlamentarëve", që po mbahet në Vjenë. Reçica ishte i ftuar, në mesin e shumë përfaqësuesve të nivelit të lartë botëror, që të diskutojë për temën "Rrugët e paqes në Ballkan", në cilësinë e ambasadorit të paqes dhe si ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ai ka thënë se mburoja e aleatëve të NATO-s është ajo që i duhet dhe do t'i duhet rajonit tonë. "Në rajon, në këtë rast edhe në Kosovë, jetojmë të lirë duke iu falënderuar përpjekjeve të shumë brezave për liri dhe paqe dhe luftës së fundit të imponuar, qëllimin e së cilës e kuptoi drejt edhe faktori ndërkombëtar, si rezultat i së cilës, patëm edhe ndërhyrjen e botës demokratike, forcave të NATO-s, të cilave gjithmonë do t'u jemi falënderues për krijimin e kësaj paqeje, pa të cilën të paktën unë nuk do të isha pjesë e këtij paneli", është shprehur

Reçica. Sipas tij, rajoni në brishtësinë e tij shihet arenë e përshtatshme për çdo lloj ekstremizmi, duke përfshirë sidomos atë fetar. "Ekstremizmat po provojnë gjithë këto vite të ndërtojnë një orbitë të tyre, me qëllim interferimi. Përdorimi i fesë për qëllime politike dhe të shtrirjes ushtarake dhe ekonomike në vetvete nuk është vetëm një ekstremizëm fetar, por edhe një synim me qëllim ndikimi gjeopolitik mbi rajonin", ka theksuar Reçica, duke shtuar se, fatkeqësisht, po mbretëron ende një agjendë për t'u goditur nga politikat agresive, edhe pse Kosova është shumë e angazhuar për ruajtjen e paqes, mbrojtjen dhe sigurinë e të drejtave të njeriut, në veçanti të komuniteteve, të drejta të cilat janë të garantuara edhe me Pakon e Ahtisaarit dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. "Në këtë rast, dua të theksoj se Serbia jo vetëm se heziton të na njohë, por ajo po bën shumë për të na penguar në rrugën tonë drejt zhvillimit dhe integrimit. Ajo duhet ta kuptojë se Kosova është një shtet i pavarur me synim të qartë, zhvillimin ekonomik, ruajtjen e paqes dhe qëllimin kryesor: anëtarësimin në Bashkimin Evropian. E mira është që populli ynë është orientuar drejt Perëndimit. Duhet që edhe vendet fqinje të kuptojnë se



rajoni ka nevojë për dy gjëra krejt bazike: paqe dhe zhvillim", është shprehur ai. Sipas Reçicës, sot të gjithë jemi të bindur se paqja mes nesh ruhet përmes dialogut të brendshëm, duke e pranuar njëri-tjetrin ashtu sikur jemi dhe aty ku jemi, duke e pranuar diversitetin tonë si vlerë e jo si pengesë e rrezik, duke aspiruar bashkimin në familjen e përbashkët, e jo duke

i vënë njëri-tjetrit shkopinj në rrota. "Vetëm të bashkuar në familjen tonë të përbashkët në Bruksel qoftë për Bashkimin Evropian, qoftë për mbrojtjen e sigurinë nën mburojën e NATO-s, rajoni ynë do të lë pas të kaluarën e mbushur me gjak e luftëra", ka theksuar Reçica. Për ta pasur rajonin tonë edhe më të sigurt e më të plotësuar, ministri Reçica ka thënë se

duhet që Greqia, si një shtet me traditë të Bashkimit Evropian, ta pranojë pavarësinë e Kosovës. "Ne e thërrasim edhe me këtë rast që ajo ta jap shembullin dhe ta bëjë nismën e këtij ngërçi të pesë shteteve të Bashkimit Evropian. Pavarësia e Kosovës është edhe detyrë greke, sepse ne jemi fqinjë dhe kemi shumë rrugë për të bërë bashkë", ka deklaruar Reçica.

Katër vetëvrasje për tre muaj



Prishtinë, 29 prill - Vdekja e një polici dhe një doktorese në Gjilan, së fundmi edhe rasti i vdekjes së aktorit të serialit komik 'O sa mirë', Art Kurti, janë shënuar si akte të vetëvrasjes nga Policia e Kosovës. Gjatë tre muajve të këtij viti në Policinë e Kosovës janë shënuar katër vetëvrasje, por ka edhe raste të tjera të cilat janë iniciuar si vdekje e dyshimtë. Policia e Kosovës i ka thënë "Kallxo.com" se kësaj çështjeje i qasen në aspektin e hetimit të aktit si akt. Sipas statistikave të Policisë së Kosovës, në vitin 2015 janë evidentuar 60 vetëvrasje dhe

219 tentimvetëvrasjeje, në vitin 2016 janë evidentuar 37 vetëvrasje dhe 229 tentimvetëvrasjeje dhe në vitin 2017 janë evidentuar 32 vetëvrasje dhe 216 tentimvetëvrasjeje. "Sa i përket gjinisë dhe moshës së viktimave të rasteve të vetëvrasjeve, nuk mund të themi se është një moshë e caktuar që dominon, edhe pse raste pak më të shpeshta janë ato me viktima të moshave nga 18 deri 40-vjeçare", thuhet në përgjigjen e policisë. Personat e gjinisë mashkullore, sipas policisë, prijnë në kryerjen e aktit të vetëvrasjes.

Intervistë me drejtorin e D&D Business Support Center, Safet Fazliu

Duhet të ketë më shumë investime



Drejtori i D&D Business Support Center, Safet Fazliu, i cili më parë ishte drejtor i Agjencisë për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme në kuadër të MTI-së, ka thënë se në Kosovë duhet të aplikohet modeli i Partneritetit Publiko-Privat (PPP) sa iu përket investimeve në resorët e mëdhenj. Ai në një bisedë për gazetën "Epoka e re" ka thënë se ka iniciativa të pakta në investime përmes PPP-ve. Fazliu ka pohuar se vendi ynë ka potenciale dhe mundësi të shumta për shtimin e investimeve përmes PPP-ve, në veçanti në nivelin lokal

kontratë të investimit përmes partneritetit publiko-privat me kompaninë amerikane "Contour Global" për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re", e që ky pritet të jetë investimi më i madh në Kosovë përmes PPP deri tani.

"Epoka e re": A ka vullnet në Kosovë për një bashkëpunim të tillë?

Fazliu: Si do që të jetë, vendi ynë ka potenciale dhe mundësi të shumta për shtimin e investimeve përmes PPP-ve, në veçanti në nivelin lokal, investime këto me interes të madh për zhvillimin e vendit dhe zvogëlimin e papunësisë. Për këtë, në rend të parë nevojitet një vullnet shumë më i madh politik si dhe ngritje e kapaciteteve institucionale pasi këto projekte kërkojnë analiza dhe studime profesionale paraprake në një rënë anë, po ashtu për realizimin e tyre kërkohen ekspertë të përkushtuar për të gjitha fazat e zhvillimit të këtyre projekteve, në veçanti për monitorimin e tyre kur dihet mirëfilli se këto kontrata janë shumëvjeçare.

"Epoka e re": Sipas jush, cila është rëndësia e investimeve në bazë të Partneritetit Publiko-Privat?

Fazliu: Partneriteti Publiko-Privat tashmë është i njohur si koncept zhvillimor dhe si mundësi për nxitjen e rritjes ekonomike në të gjithë botën. Ato po aplikohen si mundësi për përshejtimin e rritjes ekonomike përmes zhvillimit të sektorëve të ndryshëm, veçanërisht në sektorin e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Ky model i ri i zhvillimit ekonomik ndihmon rivitalizimin ekonomik, krijimin e vendeve të

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 29 PRILL -

"Epoka e re": Z. Fazliu, sa ka pasur investime në Kosovë në bazë të Partneritetit Publiko-Privat (PPP)?

Fazliu: Që nga viti 2009 Kosova ka një mjedis ligjor dhe institucional si dhe një direktivë që rregullon

sistemin e PPP-së, të qartë, modern dhe në përputhje me direktivat e BE-së. Pavarësisht prej kësaj, përvoja e institucioneve të Kosovës për identifikimin, implementimin dhe monitorimin e projekteve përmes PPP-ve është ende modeste. Si rrjedhojë e kësaj, kemi iniciativa të pakta në investime përmes PPP-ve, me një sasi të kufizuar investimesh që

janë përmbyllur dhe disa të tjera në planifikim e sipër. Përveç Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, si një projekt më i madh investiv që është realizuar përmes koncesionimit si një nga format e PPP-ve dhe disa projekteve të vogla në komuna, deri më tani nuk është realizuar ndonjë investim që vlen të theksohet përmes PPP-ve. Vlera e inves-

timeve të përgjithshme përmes PPP-ve vlerësohet të jetë rreth 100 milionë euro, e që në këtë shumë Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës përbën pjesën dërmuese të investimeve, pasuar me disa investime të vogla në komunën Gjilan dhe Prizren. Krahas investimeve të deritanishme, Qeveria e Republikës së Kosovës tashmë ka hyrë në një

të partneritetit publiko-privat

punës dhe transformimin e rajoneve të pazhvilluara në qendra gjallëruese që tërheqin biznese të reja dhe investime private. Ndonëse PPP-të ndryshojnë nga shteti në shtet, ato zakonisht përfshijnë partnerë publikë dhe privatë që punojnë në bashkëpunim për ta nxitur financimin, talentet, teknologjitë dhe ekspertizën, si sinerji për të promovuar investime të reja dhe zhvillim. Për qeveritë lokale, me kufizime buxhetore, PPP-të janë bërë mjete të fuqishme për të realizuar një sërë investimesh të zhvillimit ekonomik lokal që, përndryshe, nuk do të kishin mundur të ndodhnin. Ky koncept zhvillimor, kur shoqërohet me politika të duhura, mjedis ligjor dhe institucione funksionale, mund të jetë një katalizator i fuqishëm për rritje ekonomike të vendit tonë. PPP-të mundësojnë rritje të

investimeve të brendshme nga sektori privat dhe mundësi për investime të huaja direkte, si dhe përmes saj, zhvillim ekonomik lokal, shtim të vendeve të punës, përmirësim të shërbimeve publike për qytetarët, modernizim të infrastrukturës dhe mirëqenie më të mirë sociale për qytetarët. Siç e cekem edhe më parë, për nxitjen dhe promovimin e kësaj mundësie në rend të parë nevojitet një vullnet më i madh politik në Kosovë. Vlen të theksohet se Kosova ka krijuar kornizë të mirë ligjore në këtë fushë, ndërsa kapacitetet institucionale për inicim, procedura kontraktuese dhe monitorim të këtyre projekteve nuk janë mjaft të zhvilluara, në veçanti në nivelin lokal. Ne, respektivisht D&D Business Support Center, me përkrahjen edhe të Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal,

vitin e kaluar kemi hartuar një udhëzues, gjegjësisht manual praktik për PPP, i cili u është dedikuar komunave në rend të parë, por shpresojmë se do t'ju shërbejë edhe institucioneve në nivelin qendror si dhe kompanive private të interesuara për këtë fushë.

"Epoka e re": Në cilat raste apo kompani do të ishte profitabil për vendin privatizimi në bazë të PPP-së?

Fazliu: Sferat në të cilat sektorët publikë dhe privatë mund të ndërveprojnë janë të shumta dhe ato gjejnë aplikim në sektorë të shumtë ekonomikë dhe shoqërorë, të cilët deri dikur kanë qenë sektorë ekskluzivë të shtetit, përfshirë: arsimin, shëndetësinë, ambientin, punësimin, sigurinë, strehimin social, infrastrukturën e transportit, telekomunikacionin,

sportin dhe rekreacionin, turizmin dhe kulturën, bujqësinë, parqet industriale, energjinë elektrike, ngrohjen, ujësjellës dhe kanalizime, hedhurinat, objektet qeveritare dhe publike, resurset natyrore etj. fusha këto të cilat janë të përkufizuara edhe në Ligjin për PPP. Vlen të theksohet se komunat tona kanë potenciale dhe fleksibilitet të madh për të realizuar investime të shumta përmes PPP-vë, në veçanti në infrastrukturë dhe shërbime publike, e që për çudi, një gjë e tillë nuk është duke ndodhur. Nëse e marrim si shembull Komunën e Prishtinës, rasti i blerjes së autobusëve përmes kredisë milionëshe e cila do të paguhet nga taksat e qytetarëve dhe për të cilën komuna është lavdëruar shumë, investimi i njëjtë ka mundur të realizohet përmes një partneriteti publiko-privat të

thjeshtë dhe pa asnjë cent investim nga komuna pasi që shërbimi i transportit publik do të konsiderohej profitabil nga investitorët privatë. Në anën tjetër, investitori privat, përveç investimit për blerjen e autobusëve, do t'i paguante komunës edhe tarifë mujore për ekskluzivitetin që do t'i jepej për këtë shërbim, respektivisht biznes. Për më tepër, një operator privat do të ofronte shërbim shumë më cilësor, në rastin konkret shërbime të transportit publik, sesa që ofron një ndërmarrje publike komunale. Ndonëse morëm si shembull një investim konkret në Komunën e Prishtinës, ka shumë investime të tjera shumë të nevojshme që do mund të bëheshin përmes PPP-ve jo vetëm në Prishtinë, por edhe në komunat e tjera që, fatkeqësisht, nuk janë në situatë më të mirë në këtë drejtim.

Gashi kërkon të jetësohet ideja për themelimin e bankës së diasporës



PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Zëvendëskryeministri dhe ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, në Gjermani ka hapur takimin e parë të anëtarëve Premium të Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane. Në këtë takim, ku

morën pjesë rreth 60 biznese premium, nga më shumë se 300 anëtarë që ka Unioni, ministri Gashi në fjalën hyrëse ka potencuar nevojën që afaristët dhe bizneset shqiptare në diasporë të avancojnë në fazë tjetër të bashkëpunimit me Kosovën, në

fazën e projekteve kapitale siç është projekti i Bankës së Diasporës, projekte që ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës. "Puna që ka bërë Unioni që nga themelimi me një qasje profesionale e serioze, ka bërë që Qeverinë e Republikës së

Kosovës ta ketë partner në rrugëtimin e saj. Andaj, rekomandoj që kjo nismë e juaja të avancojë në fazë tjetër, atë të realizimit të projekteve kapitale të Unionit. Ideja juaj për Bankën e Diasporës, por edhe projekteve të tjera, të fillojë të zbatohet", ka

deklaruar Gashi. Në mesin e shumë pjesëmarrësve në këtë takim ishin edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj si dhe kryetari i Nderit të Rrjetit Global të Bizneseve Shqiptare në Diasporë, Lazim Destani.

Aliu: 'Bashkimi i qytetit' të Ferizajt, afër realizimit

FERIZAJ, 29 PRILL - Brenda muajt maj do të përfundojë plani për projektin e "Bashkimit të qytetit" në komunën e Ferizajt, pastaj do të fillojë procesi i tenderimit i cili do t'i hapë rrugë edhe fillimit të realizimit të këtij projekti. Kështu ka bërë me dije kryetari i Ferizajt, Agim Aliu. Ai ka thënë se kostoja e këtij projekti do të jetë 2.5 milionë euro.

Kryetari Aliu ka thënë për "Kosovapress" se me ndërtime e nënkallimit për vetura, përveç eliminimit të kaosit në komunikacion, do të bëhet edhe ruajtja e këmbësorëve, si dhe do të mundësohet qasje e lehtë nga rruga "Vëllezërit Gërvalla" e deri tek rruga "Madeleine Albright". "Ferizaj do të transformohet dhe do të jetë një qytet shumë atraktiv", ka thënë Aliu.



Asfaltohet rruga 'Fehmi Lladrovci' në Prishtinë

PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Ka përfunduar asfaltimi i rrugës "Fehmi Lladrovci" në Komunën e Prishtinës. Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka falënderuar

kompaninë për asfaltimin e kësaj rruge. "Falënderojmë kompaninë që gjatë javës ka punuar në mbrëmje dhe po e asfalton të dielën me ndikim

minimal në jetën e qytetarëve", ka deklaruar Ahmeti. Asfaltimi i rrugës "Fehmi Lladrovci" ka përfunduar dy javë para kohe.



Haziri drejton Gjilanin me AAK-në dhe AKR-në

GJILAN, 29 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Lufti Haziri, ka arritur koalicionin me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Aleancën Kosova e Re (AKR), për të bashkëqeverisur në këtë komunë. Ndonëse në nivelin qendror LDK-ja e Hazirit është duke e kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Ramush Haradinaj, i cili është lider i AAK-së, kjo nuk i ka penguar për bashkëqeverisje në këtë komunë.

Lufti Haziri do të ketë përballë një opozitë shumë të fortë. Në opozitë në Gjilan janë Lëvizja Vetëvendosje dhe PDK-ja me nga gjashtë asamblistë, Nisma Socialdemokrate me katër dhe një asamblist i pavarur. Këta 17 këshilltarë opozitarë mund të bëjnë një opozitë tejet të fortë të qeverisjes LDK-AAK-AKR. "Marrëveshja për bashkëqeverisje për Gjilanin 2021+ do të thotë marrëveshje për programe për zhvillim të infrastruk-

turës, të arsimit, të kujdesit shëndetësor, të zhvillimit lokal ekonomik, të pakos për familjen bujqësore, të zhvillimit të politikave të rinisë, të avancimit të gruas në vendimmarrje dhe për një sport të afirmuar edhe ndërkombëtarisht", ka thënë Haziri. Marrëveshja politike sot (e hënë) do t'i zbardhë emrat e bartësve të politikave sektoriale. Lufti Haziri edhe në mandatin e kaluar ka bashkëqeverisur me AAK-në.

Haskuka kërkon ndihmën e qytetit të Beratit për aplikim në UNESCO

Prizren, 29 prill (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka pritur në takim homologun nga qyteti i Beratit, Petrit Sinaj. Haskuka ka bërë me dije se Komuna e Prizrenit ka iniciuar projektin e binjakëzimit me atë të Beratit. "Me ftesën tonë për inicimin e binjakëzimit të komunës sonë me qytetin e Beratit e kemi në vizitë delegacionin nga ky qytet i lashtë. Prizreni dhe Berati kanë shumëçka të përbashkët. Të dyja qytetet shqiptare kanë histori mbi 2000-vjeçare, reliefin me kala në krye, lumenjtë, malet dhe shtëpi të bukura me shumë dritare. Me kryebashkiakun Petrit Sinaj dhe delegacionin nga Berati hapëm rrugën e vëllazërisë, ndërsa u pajtuam për bashkëpunim kulturor,



ekonomik si dhe për bashkëpunim në arsim", ka thënë Haskuka. Ai ka thënë se Berati mund ta ndihmojë Prizrenin në procesin e aplikimit për në UNESCO. "Mundësia për këmbimin e turneve të turistëve që vizitojnë këtë pjesë të botës do të jetë në dobi të dy qyteteve, ndërsa Berati mund ta ndihmojë Prizrenin në procesin e aplikimit në UNESCO", ka deklaruar Haskuka.

Ministri Ismaili mbështet Spitalin e Gjilanit

GJILAN, 29 PRILL (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka vizituar Spitalin e Gjilanit për të parë nga afër punën dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet ky spital. Me këtë rast, ai ka uruar edhe drejtorin e ri të këtij spitali, Nysret Hajrullahun, i cili, sipas tij, ka marrë një detyrë me përgjegjësi të lartë.



"E sigurova drejtorin Hajrullahu se do ta ketë përkrahjen time në secilin hap në punën e tij, në të mirë të qytetarëve të Gjilanit. Spitalet rajonale janë shumë të rëndësishme për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët në vendin ku jetojnë, andaj këtë vit kemi në plan që përmes investimeve konkrete në pajisje dhe infrastrukturë t'i përmirësojmë kushtet e tyre", ka thënë Ismaili.

Dokumentari për viktimat e dhunës seksuale të luftës në Kosovë shfaqet në Sidnej

Nga Robert CARR, politolog australian

Filmi "Mendoj për ty" u shfaq më 27 prill në Qendrën e Kongresit në Sidnej, një dokumentar që trajton çështjen e pazgjidhur të viktimave të dhunës seksuale, të kryer gjatë luftës në Kosovë.

Filmi kryesisht në gjuhën shqipe (me titra në gjuhën angleze) po shfaqet gjithandej botës (në të paktën dymbëdhjetë shtete deri më tani).

Artistja në qendër të filmit, Alketa Mripa-Xhafa, së bashku me producenten Anna Di Lellio (një sociologe dhe një konsulente e mëparshme në misionin e KB-së në Kosovë) dhe tashmë ish-presidenten Atifete Jahjaga, në vitin 2014 kanë themeluar Këshillin Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës.

Në panel presidentes Jahjaga iu bashkua ambasadori i Republikës së Kosovës në Australi, Sabri Kiçmari. Aty u diskutua për sfidat morale, politike e historike me të cilat Kosova përballlet në mënyrë që të rregullojë dhe riadresoje dhunën seksuale shumë të përhapur shkaktuar kundrejt grave dhe vajzave gjatë luftës në vitet e '90-ta nga serbët dhe

forcat ushtarake të udhëhequra nga serbët.

Rreth 20 000 mijë gra dhe vajza shqiptare të Kosovës iu nënshtruan përdhunimit sistematik gjatë luftës së Kosovës. Një temë që e shqyrtoj në librin tim në Kapitullin 2 te Brezat dhe refugjatët, nga historianët që merren me luftërat e suksesioneve të viteve 1990 përdhunimi shihet në masë të madhe si një armë që është rezultat i drejtpërdrejtë i spastrimit etnik.

Përdhunimi si një armë e luftës është metodë shumë e vjetër e luftës që shërben për ta dermoalizuar popullatën armike dhe për të minuar lidhje kulturore, shoqërore e fetare midis këtyre komuniteteve.

Por gjatë luftës në ish-Jugosllavi përdhunimi mori formë të veçantë dhe është një fenomen i ri për shkak se është kryer në mënyrë të koordinuar dhe sistematike.

Larg nga imazhi i një ushtrie ruse që kërkonte saktë hakmarrje për popullsinë e saj të nënshtruar nga gjermanët në Luftën e Dytë Botërore, ose ato të garnizonëve romakë të udhëhequr nga Cezari që, me sa duket, po plaçkitnin rrugën e tyre nëpër Gal, kampet e "përdhunimeve" dhe "fabrikat" u orkestruan e u vendosën në konfliktet në Ballkan me qëllim të qartë të



"edukimit" të bashkësive etnike armike.

"Mendoj për ty" dokumenton donacionin e 5 000 veshjeve nga gratë (dhe disa burra) nëpër gjithë Kosovën. Veshjet pastaj shfaqen në një instalim të madh artistik në stadiumin e futbollit të Prishtinës. Çdo fustan "ka një histori personale për të treguar", thotë regjisorja artistike Mripa-Xhafa gjatë filmit. Në një qark me një popullsi prej pak më shumë se dy milionësh, numri dukshëm i madh i 20 000 viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës do të thotë se pashmangshëm instalimi artistik do të jetë një përjetim emocional e shumë personal për qytetarët në mbarë Kosovën.

Filmi lë shikuesin me një mori emocione - jo vetëm zemëri-

mi, trishtimi dhe dhembshurie, por edhe një ndjenjë që, duke iu drejtuar të kaluarës në këtë mënyrë, mund të gjendet një njohje për viktimat dhe përfundimisht një bisedë e krijuar në nivel shtetëror për t'i sjellë autorët e krimeve para drejtësisë.

Kiçmari, duke prezantuar filmin, u tha të pranishmëve: "Mënyra më e lartë e dhunës çnjerëzore ishte abuzimi i grave [gjatë luftës]. Duke themeluar iniciativa shtetërore të riintegritit dhe rehabilitimit për gratë që vuanin nga dhuna seksuale e përjetuar gjatë luftës, Jahjaga si presidente luajti rol kryesor në ngritjen e vëmendjes ndaj kësaj çështjeje brenda dhe jashtë vendit. Ajo ka drejtuar 'një agjendë' për ta kapërcyer stigmën e dhunës seksuale, duke krijuar infrastrukturë për të mbijetuarit në mënyrë që t'u garantohen të drejtat", ka thënë Kiçmari.

Kur presidentja Jahjaga mori detyrën u përball me një sfidë të madhe për të ndërtuar të ardhmen për viktimat për shkak se, siç u shpreh ajo, "shumica e autorëve të krimit mbetën të lirë".

Ndërkohë, shtoi ajo, viktimat

mbetën "të heshtura nga shoqëria jonë dhe nga sistemi ynë".

Si presidente, "vendosa të veproj. Pra, në mars të 2014-s kam themeluar Këshillin Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale. Ishte koha kur bëmë një angazhim kombëtar për ta thyer heshtjen".


Instalacioni artistik "Mendoj për ty" na kujton urtësisht se lëvizja #metoo nuk është vetëm për atë që po ndodh në Hollywood.

Sot ekzistojnë praktika të vazhdueshme historike dhe të rrënjësura të dhunës seksuale në mbarë botën, pasojat e të cilave ndjehen dhe jetojnë ende, por normalizohen dhe institucionalizohen.

Dhuna e tmerrshme seksuale e kryer në një kontekst lufte është njohur relativisht vonë në Ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, vetëm që nga Lufta e Bosnjës.

Misioni artistik i përshkruar në "Mendoj për ty" duket se ka shërbyer për të krijuar dhembshuri për viktimat, por edhe veprime konkrete shtetërore në emër të tyre.

Në të dyja këto çështje, të paktën në Kosovë, duket sikur është arritur një sukses që kur presidentja Jahjaga mori detyrën. Funkcionet e Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale të përcaktuara nga Dekreti Presidencial i presidentes Jahjaga në vitin 2014 përfshijnë koordinimin e institucioneve për forcimin e mekanizmave për t'i mbështetur të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës, zhvillimin e legjislacionit dhe politikave për mbështetjen e të mbijetuarve dhe ngritjen e vetëdijes për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës.



Bekim Jupa: RDK-ja në Gjakovë po zhvillon proces të suksesshëm zgjedhor

Gjakovë, 29 prill (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka filluar procesin e brendshëm zgjedhor, i cili do të përfundojë deri në fund të këtij viti. Në kuadër të këtij procesi zgjedhor do të zgjedhen organet e reja të kësaj partie. Fillimisht procesi zgjedhor i rinisë së PDK-së është duke u mbajtur në të gjitha komunat. Edhe në Komunën e Gjakovës ka filluar që kjo parti të mobilizohet në këtë proces zgjedhor.

Bekim Jupa, zyrtar i lartë i Degës së Partisë Demokratike (PDK) në Gjakovë, shef i grupit parlamentar i kësaj partie në Kuvendin Komunal të Gjakovës, që tash së fundmi është emëruar zëvendës-

ministër i Tregtisë dhe Industrisë, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se procesi zgjedhor i rinisë së PDK-së në këtë komunë është duke ecur shumë mirë. Ai ka thënë se motos së PDK-së "Dekada e Re" janë duke iu bashkangjitur shumë të rinj të Komunës së Gjakovës, të cilët pastaj do të jenë bartës të politikave të strukturave të reja të Rinisë Demokratike të Kosovës (RDK) në këtë komunë. "Në Komunën e Gjakovës ka nisur procesi zgjedhor, në të cilin po shihet se ka interesim shumë të madh nga të rinjtë për PDK-në, me moton e saj 'Dekada e Re', e cila synim ka një qasje plotësisht të re në përfshirjen e të rinjve në



politikë, duke ruajtur njëkohësisht traditën e mirë që kemi ndërtuar si parti në krijimin e hapësirës politike për angazhimin e të rinjve në vazhdimësi. Rinia Demokratike në Gjakovë është duke zhvilluar një proces të suksesshëm zgjedhor", ka thënë Jupa, duke shtuar se rinia do të jetë

mekanizmi kryesor i ndryshimit të partive dhe vendit.

Ai ka thënë se PDK-ja në Gjakovë ua ka hapur dyert rinisë që ta japin kontributin e tyre të çmuar për shtetin përmes kësaj partie. "Jemi të interesuar që ky proces zgjedhor si në Gjakovë, po ashtu edhe në nivel vendi, të përfundojë qysh është më së miri. Fuqizimi që jemi duke marrë nga të rinjtë në Gjakovë është sinjal se PDK-ja vazhdon të mbetet subjekti më i pëlqyer nga rinia", ka thënë ai.

Zëvendësministri Bekim Jupa u ka bërë thirrje të rinjve të angazhohen për një proces transparent dhe ta japin kontributin e tyre për shtetin në kuadër të PDK-së. Ai ka shtuar se

Kosova duhet të ecë fuqishëm përpara në procese zhvilluese dhe integruese por kjo, sipas tij, nuk mund të bëhet pa angazhimin e rinisë e cila duhet të marrë përgjegjësinë e vet. "Rinia në Gjakovë ka vullnet të jashtëzakonshëm për angazhim në jetën politike dhe duhet të ketë rol aktiv në 'Dekadën e Re'", është shprehur Jupa. Ai ka thënë se me potencialin që e ka rinia jonë, i garanton PDK-së fuqizim dhe përkrahje më të madhe në Gjakovë.

Jupa ka bërë me dije se në fund të procesit të përgjithshëm zgjedhor, PDK-ja do të dalë një parti e fuqishme, e cila do të vazhdojë të jetë më e kërkuara nga qytetarët.

May dhe Macroni i bëjnë thirrje Botës për luftimin e armëve kimik

PARIS, 29 PRILL - Presidenti francez, Emmanuel Macron dhe kryeministria britanike, Theresa May, i kanë bërë thirrje Botës të dielën për ta vazhduar luftën kundër armëve kimike, në përvjetorin e një konvente ndërkombëtare që ndalon përdorimin e këtyre armëve, transmeton AFP. "Në përvjetorin e 21-të të Konventës së Armëve Kimike dhe rastin në Duma e Sallsbëri, Theresa May dhe unë,

i bëjmë thirrje botës për të na u bashkuar në ndalimin global të përdorimit të armëve kimike", ka thënë Macroni përmes një postimi në "Twitter", duke iu referuar sulmeve kimike në Siri dhe Britani.

Zyra e kryeministres May ka publikuar një deklaratë të ngjashme, duke thënë se "ne nuk duhet kurrë të kthehemi mbrapa" sa i përket dhënies fund të prodhimit dhe përdorimit të "këtyre armëve të tmerrshme".

Armët kimike siç është gazi mustard janë përdorur fillimisht në betejat e Luftës së Parë Botërore dhe më pas nga diktatori iranian Saddam Hussein kundër civilëve në Halabja më 1988. Konventa për Armët Kimike, e cila parasheh shkatërrimin e këtyre armëve, ka nisur zbatimin më 29 prill 1997.

Armët kimike siç është gazi mustard janë përdorur fillimisht në betejat e Luftës së Parë Botërore dhe më pas nga diktatori iranian Saddam Hussein kundër civilëve në Halabja më 1988. Konventa për Armët Kimike, e cila parasheh shkatërrimin e këtyre armëve, ka nisur zbatimin më 29 prill 1997.



Pompeo viziton Arabinë Saudite, akuzon Iranin

Pas takimit në Riad, Pompeo ka akuzuar Iranin për destabilizim të Lindjes së Mesme duke mbështetur presidentin sirian, Bashar al-Assad dhe për përkrahjen e rebelëve huthi në Jemen

WASHINGTON, 29 PRILL - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, është duke shtyrë komunitetin ndërkombëtar për të sanksionuar persona dhe subjekte që janë duke ndihmuar programin raketor të Iranit, ka njoftuar një zyrtar i lartë.

Aktualisht Pompeo është duke vizituar Lindjen e Mesme. "Ne jemi duke u bërë thirrje shteteve në gjithë botën të sanksionojnë çdo individ dhe subjekt të lidhur me programin raketor të Iranit dhe kjo ka qenë pjesë e madhe e diskutimeve me evropianët", ka deklaruar këshilltari i lartë politik, Brian Hook, që ndodhet bashkë me Pompeon në Arabinë Saudite. "Raketat e Iranit zgjasin luftën dhe vuajtjet në Lindje të Mesme. Ato kërcënojnë sigurinë dhe interesat ekonomike dhe kërcënojnë sidomos Arabinë Saudite dhe Izraelin", ka thënë ai.

Pompeo, që është betuar këtë javë në pozitën e sekretarit amerikan të Shtetit, ka arritur në Riad në kuadër të udhëtimit të tij në Lindje të Mesme, pas pjesëmarrjes së tij në takimin e ministrave të Jashtëm të NATO-s në Bruksel.

Pas takimit të tij më 29 prill me Mbretin Salman të Arabisë Saudite, ai është nisur drejt Tel-

Avivit dhe më pas do ta vizitojë edhe Jordaninë. Pas takimit në Riad, Pompeo ka akuzuar Iranin për destabilizim të Lindjes së Mesme duke mbështetur presidentin sirian, Bashar al-Assad dhe për përkrahjen e rebelëve huthi në Jemen.

Duke folur në një konferencë të përbashkët me ministrin e Jashtëm të Arabisë Saudite, Adel al-Jubeir, Pompeo ka thënë se "Irani mbështet rrjetëzime të milicisë dhe grupe terroriste". "Është një tregtar i armëve për rebelët huthi në Jemen dhe irani zhvillon fushata kibernetike. Po ashtu, mbështet regjimin vrasës të Assadit", ka thënë Pompeo. "Për dallim prej administratës së kaluar ne nuk do t'i neglizhojmë aktivitetet terroriste të Iranit", është shprehur ai.

Në Arabinë Saudite, Pompeo ka theksuar nevojën e unitetit në Gjirin Arab. "Uniteti i Gjirit Arab është i nevojshëm dhe neve na duhet ta arrijmë atë", ka thënë Pompeo në një konferencë për media.

Arabia Saudite, së bashku me Emiratet e Bashkuara, Bahrejin dhe Egjiptin, kanë ndërprerë marrëdhëniet tregtare dhe ato të udhëtimit me Katarin në qershor të vitit të kaluar, duke akuzuar atë për mbështetje të

terrorizmit dhe Iranit.

Doha i ka hedhur poshtë akuzat duke thënë se shtetet në fjalë kanë për qëllim kufizimin e sovranitetit të Katarit.

Udhëtimi i tij vjen në kohën kur po afrohet 12 maji, njëherësh afati i fundit i deklaruar nga presidenti amerikan, Donald Trump, për t'i rregulluar, siç ka thënë ai, të metat e tmerrshme të marrëveshjes bërthamore që Irani ka nënshkruar me fuqitë botërore më 2015. Në të kundërtën, Trumpi ka paralajmëruar se do ta largojë ShBA-në nga kjo marrëveshje.

Britania, Franca, Gjermania,

Rusia dhe Kina që janë pjesë e marrëveshjes, i kanë bërë thirrje Uashingtonit të vazhdojë të jetë pjesë e paktit, duke thënë se kjo është mënyra më e mirë që Irani mund t'i parandalohen aktivitetet bërthamore.

Mirëpo Trumpi ka thënë se Teherani ka shkelur "shpirtin" e marrëveshjes duke vazhduar testimin e raketave balistike dhe duke nxitur dhunë në Lindje të Mesme.

Irani në anën tjetër i hedh poshtë vazhdimisht këto akuza. Sipas paktit, Iranit i është premtuar lirim nga sanksionet në këmbim të frenimit të programit

bërthamor.

Pompeo ka thënë në një konferencë për media në Bruksel, se ende nuk është marrë "asnjë vendim" lidhur me pjesëmarrjen e ShBA-së në këtë pakt. Mirëpo ai ka thënë se nëse nuk bëhen ndryshime substanciale, ka shumë mundësi që Trumpi të largohet nga marrëveshja.

Pompeo, i cili ka shërbyer drejtor i CIA-s para se ta fitonte pozitën e sekretarit të Shtetit, ka qenë një nga zyrtarët e parë në administratën e Trumpit që ka vizituar Arabinë Saudite në fillim të pozitës së tij si shef i agjencisë.



Koreja Veriore fton ekspertë amerikanë gjatë mbylljes së centralit bërthamor

SEUL, 29 PRILL - Lideri i Koresë Veriore, Kim Jong Un, i ka thënë presidentit jugkorean, Moon Jaemin, se ai do ta mbyllë zonën shtetërore të testimit bërthamor në muajin tjetër, ka njoftuar zyra e presidentit jugkorean. "Kimi ka thënë gjatë samitit se ai do të përkujdeset për mbylljen e zonës së testeve bërthamore në maj", ka thënë një zëdhënës për gazetaret më 29 prill.

Kimi ka thënë se ai do të "ftojë ekspertë nga Koreja Jugore dhe Shtetet e Bashkuara për ta shikuar procesin në mënyrë që të jetë sa më transparent para komunitetit ndërkombëtar", ka thënë zëdhënësi, Yoon Young-chan.

Zyra presidenciale e Koresë Jugore ka thënë se Kimi ka premtuar se do të ftojë ekspertë amerikanë dhe gazetarë për ta shikuar procesin e mbylljes së zonës.

Në samitin e tyre historik më 27 prill, Kimi dhe Mooni kanë premtuar se do t'i largojnë armët bërthamore nga Gadishulli Korean si dhe kanë treguar se synojnë t'i japin fund Luftës Koreane të zhvilluar mes viteve 1950-1953. Presidenti amerikan Donald Trump pritet të takohet me liderin verikorean në tri apo katër javët e ardhshme, ka thënë lideri amerikan.



Shqipëria, media e saj dhe Pranvera e vitit 1981 në Kosovë (2)



Bedri ISLAMI

Thënë të vërtetën unë kisha disa kohë që isha përgatitur për një udhëtim në Kosovë, i cili, siç më kishte thënë shefi im i atëherëshëm, Namik Dokle, do të bëhej në fundin e muajit mars. E dija se në atë grup do të ishte edhe Vera Kapo, bija e numrit dy të dikurshëm PPSH-së, Hysni Kapo dhe nëna e gazetarit të sotëm Andi Bushati, Xhafer Dobrusha, pedagog në Universitetin e Tiranës, që drejton sot Federatën e Arsimit dhe disa të tjerë.

Kishte disa kohë që marrëdhëniet në dy anët e kufirit ishin në një pikë të lartë intensifikimi. Kishte më shumë se pesë vite që mes dy qeverie, në Beograd dhe në Tiranë, kishte një periudhë zbutje dhe, si duket, të dy palët kishin llogaritur të ndikonin tek njëra tjetra, përmes atyre që e quanin më të rëndësishme. Qeveria e Beogradit mendonte të ndikonte në Shqipëri duke dërguar aty, përmes strukturave të ndryshme, një nivel më të ngritur jetese, njohje më të gjerë të botës, hapje më të ndjeshme; ndërsa qeveria e Tiranës kishte menduar të ndikonte përmes shkallës së kulturës, njohjes reciproke, artit, gjuhës, traditës,

duke pasur gjithnjë në anën e saj, përkushtimin e pakufishëm të shqiptarëve matanë kufirit për shtetin amë. Këtë masë përcaktuese nuk e kishte llogaritur, ose e kishte përlogaritur keq, qeveria e Beogradit, ndërsa e kishte ditur shkëlqyeshëm qeveria e Tiranës.

Pranimi i gjuhës së përbashkët shqipe, ribotimi, pa asnjë redaktim kritik i teksteve të historisë së Shqipërisë dhe pranimi i teksteve të njëllojta, thuajse në të gjitha lëmitë, ansamblet artistike që ishin më të shpeshta se asnjëherë, këngët që ishin përgjithësisht mbi bazën e teksteve me ndjenjë të theksuar kombëtare, si ishte ajo e Pjetër Gacit "Kaçanik o shkëmb e gurë..." pritja e jashtëzakonshme që i bëhej Nexhmije Pagarushës dhe rihapja e shpejtë e këngëve të saj... të gjitha këto ishin më të se të prekshme dhe të pranueshme nga njerëzit e zakonshëm.

Kishte shumë kohë që në shtypin shqiptar, duke pasur edhe një censurë të kujdesshme, nuk shkruhej kurrë negativisht për Kosovën ose për njerëzit e saj. Termat që dolën më vonë, pas viteve '90-ta, për Kosovën ose për shqiptarët e Kosovës, atëherë as nuk njiheshin dhe as nuk lejoheshin të përdroreshin. Edhe kur flitej për masakrën e 4 shkurtit bëhej kujdes të evitohet emri i Xhafer Devës, sado që shumë gjëra ishin të ditura. Fakti që u vu më pas, se gjatë gjithë kohës që regjimi i Hoxhës ishte në pushtet kishte bërë vetëm tri përmendore të mëdha për indi-

vidë të shquar të periudhës së Pavarësisë dhe se që të tre kishin ardhur nga viset shqiptare të Kosovës, përkatësisht busti i Bajram Currit, Hasan Prishtinës dhe Isë Boletinit, apo fakti që Enver Hoxha, në shënimin e tij për Monumentin e Pavarësisë kishte kërkuar që, krahas Ismail Qemalit, të vihen në qendër të monumentit edhe figura e luftëtarit nga Kosova, kishin qenë të prekshme për njerëzit. Sado që mund të ishte apo jo dakord me regjimin, nuk mund as të ishte kundër veprimeve të tilla, të cilat, sado që mund të kishin, ashtu si u tha më pas, nënshtresa të tjera, përsëri, në kohën e dhënë, ishin të mirëpritura.

Nga ana tjetër, në universitetin e Prishtinës ishin mysafirë dhe jepnin leksionet e tyre korifentë e mendimit shkencor shqiptar, ëndërimi i plejadave shqiptare në Kosovë, si Eqrem Çabej dhe Aleks Buda, Shaban Demiraj, Androkli Kostollari, Kristo Frashëri, Rexhep Meidani, dijetarët më të shquar të shkencave albanologjike, historike, ribotohej Kadare dhe Agolli dhe Veprat e Plota të Poradecit.

Në vitin 1978, me një vëmendje tejet të veçantë u përkujtua 100-vjetori i ngjarjeve të Prizrenit dhe për herë të parë, publikisht ajo u quajt Lidhja Shqiptare e Prizrenit, duke i shtuar kështu, cilësimin Shqiptare, si shenjë e etnisë kombëtare. Deri atëherë ajo ishte quajtur thjeshtë "Lidhja e Prizrenit".

Të gjitha këto po sillnin imazhin e ri të lidhjeve të përbashkëta dhe, krejt befasisht, sidomos për njerëzit e zakonshëm, erdhi

njoftimi se në Kosovë kishte ndodhur diçka.

E vërteta është se njoftimi i parë për demonstratat e 11 marsit në Kosovë është bërë i njohur, pra publik, më 13 mars 1981, dy ditë pas zhvillimit të tyre. Ky ishte një njoftim i shkurtër, pa koment, burim i së cilës ishte agjencia e lajmeve "Tanjug" dhe i përforcuar edhe nga disa agjenci të tjera informative perëndimore. Nuk është bërë ndonjë kujdes i veçantë për afishimin e tyre dhe po ashtu, vëmendja ndaj botimit të artikullit apo dhënies së lajmit, nuk ka qenë e një rëndësie të veçantë. Në ditarin radioteleviziv të RTSH-së ai u dha, pa foto të veçanta, së bashku me lajmet e tjera, ndërsa në gazetën "Zëri i Popullit" që ishte aso kohe gazeta kryesore e vendit, me më shumë se njëqindmijë kopje në ditë, shënimi u vendos në faqen e katërt, majtas, aty ku edhe më parë vendoseshin lajmet e përgjithshme të politikës së jashtme.

Si do e përcaktojë saktësisht analisti i shquar shqiptar Shaban Sinani, "kjo ishte faza e një mpirje të dukshme të opinionit në Shqipëri, që, siç duket nga shënimet e vëzhguesve politikë, në Kosovë u shoqërua me ankth e padurim".

Ishin disa ditë, në të cilat, njerëzit e thjeshtë dhe intelektualët, ishin në pritje të një zhvillimi të ri apo edhe të ndonjë lajmi më të gjerë se kaq. Kishte një vajtje ardhje më të dendur tek njeri tjetri dhe sidomos tek të afërmit, antenat satelitore të të cilëve mund të shfaqnin pamjet

e Radiotelevizionit të Prishtinës. Mirëpo edhe aty, pas 11 marsit dhe deri më 26 mars, nuk mund të mësoje më shumë se sa një informacion të zakonshëm, shenja të dënimit të udhëheqjeve të larta politike republikane e krahinore, por të gjitha këto nuk të jepnin përmasat e asaj që kishte ndodhur.

Edhe pas shumë vitesh, secili që në një mënyrë ose në një tjetër, ka kaluar nëpër ngjarjet e asaj kohe, qoftë edhe si i jashtëm, si ishim ne në Shqipëri, nuk mund ta ketë ndjerë veten jashtë tyre. Disa gjëra mbeten në kujtesë, si ishte dita e 8 prillit 1981, kur për herë të parë, në gazetën kryesore të kohës dhe më pas, disa herë radhazi në emisione të veçantë radiotelevizive, u dha qëndrimi i shtetit shqiptar. Ishte e diel dhe kisha shkuar në shtëpinë time në Shkodër. Ishte ditë plot diell, krejtësisht pranverë. Nga të gjitha radiot e komshinjeve dëgjoja spikerin e radios tek lexonte, për të disatën herë, tekstin e plotë të "Artikullit të parë në "Zërin e Popullit". gazeta kishte dalë asaj dite me dyfishin e tirazhit të saj, pra në dyqind mijë kopje, dhe që në mëngjesin e hershëm, nuk e gjeje dot askund. Ishte shitur brenda pak çasteve dhe nëpër të gjitha qoshet e rrugëve kishin ndaluar njerëzit që kishin filluar ta lexonin, pa pritur për të shkuar në shtëpi. Jam krejt i bindur se qëndrimin e shtetit shqiptar e përkrahën të gjithë shqiptarët, edhe ata që ishin pro regjimit, edhe ata që nuk e donin atë.

(Fund)

Ministri Gashi viziton YMCA në ShBA

Prishtinë, 29 prill (ER) - Me ftesë të organizatës për rini YMCA, dega në Amerikë, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka udhëtuar për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Në kuadër të vizitës ministri do të qëndrojë në dy selitë e kësaj organizate, në Nju Jork, për t'i parë nga afër përvojat e organizatës dhe si i zhvillojnë aktivitetet në ShBA.

Gjatë kësaj vizite ministri Gashi do të takohet me udhëheqësit më të lartë të YMCA Amerika, ndër të tjerë, me Adriana Statoviç, që është udhëheqëse e programeve ndërkombëtare, e cila ndjek programin e YMCA-së edhe në Republikën e Kosovës.

Ministri Gashi synon që përmes kësaj vizite të marrë mbështetje nga YMCA-ja për shtrirje të saj në Republikën e Kosovës, ku të rinjve kosovarë do t'u jepet rasti

që të jenë pjesë e këtij rrjeti të fuqishëm në mbarë botën. "Mbetet përkushtim yni që përmes marrëveshjeve të nënshkruara që do të arrijmë në këtë vizitë, ta bëjmë shtrirjen e kësaj organizate shumë të fuqishme rinore në të paktën disa prej qyteteve të Kosovës si në: Gjakovë, Prizren, Istog, Rahovec si dhe në disa komuna të tjera", është shprehur ministri Gashi, duke shtuar se angazhimi i MKRS-së nuk do të mungojë që kjo organizatë të ketë shtrirje në të gjithë territorin e Kosovës përmes së cilës do t'u jepet mundësia mijëra të rinjve për të qenë pjesë e aktiviteteve që zhvillon kjo organizatë.

Gjithashtu, ministri Gashi do të vizitojë edhe dy kampe rinore të cilat zhvillojnë aktivitete me mijëra të rinj nga mbarë bota dhe për të parë se si ato menax-



hohen. YMCA është organizata e të rinjve, e para për nga madhësia në

Botë, e themeluar në vitin 1844. Kjo organizatë e fuqishme rinore ka shtrirje në 119 shtete

të botës. YMCA u shërben 58 milionë të rinjve në vit në mbarë botën.

E jashtëzakonshme

U dënua me vinç për të parë ndeshjen në stadium

Dashuria për ekipin e tij nuk njuh kufij, sidomos në Turqi. Një tifoz i Denizlisporit kishte marrë një vinç për ta parë skuadrën e tij të zemrës, pasi ishte dënua me 12 muaj për të mos hyrë në stadium. Burri e kishte marrë me qira vinçin që shihni në fotografi.



FOTO E DITES



Një vajzë indiane freskohet në një pishinë në Bhopal. /AFP/

E rrallë

Etiopia i kërkon Britanisë 'thesaret' e grabitura 150 vjet më parë

Etiopia bën thirrje për kthimin e objekteve të vlefshme të plaçkitura nga forcat britanike 150 vjet më parë. Thesaret e Afrikës Lindore janë aktualisht në shfaqje në Muzeun "Viktoria dhe Albert" në Londër. Ndër thesaret e çmuara është edhe një kurorë ari dhe një kupë e kapur nga



forcat britanike gjatë betejës së Maqdalës në vitin 1868, pasi trupat e plaçkitën fortesën e perandorit Tewodros II.

BARSOLETA E DITËS



Babi: Ku po ikën, moj bijë, në gjysmë të natës?

Vajza: Në banjë, babi, se më duhet urgjentisht një fotografi e re profili.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

"BLACK PANTHER" 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

"PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

"PACIFIC RIM UPRISING" (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

"RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Shoenearts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Kritikat e bëra ndaj jush po japin


rezultate pozitive në punën tuaj sepse keni marrë më të mirën prej tyre dhe i keni vënë në zbatim.



DEMI

Keni kuptuar që jeta është e përbërë

edhe nga gjëra të tjera përveç punës dhe po u dedikoheni këtyre gjërave tërësisht sot.



BINJAKËT

Iniciativat që do të ndërmerreni sot do t'u

japin shumë zgjidhje personave afër jush. Dikush do t'ju shprehë falënderimet në një mënyrë të ngrohtë.



GAFORRJA

Një problem konstant që nuk po

ju lë të avanconi duhet ta zgjidhni nga rrënjët sepse do të vazhdojë t'ju torturojë për një kohë të gjatë.



LUANI

Sot keni vënë në dukje një anë të

panjohur tuajën dhe mjaft të ndjeshme. Jeni kokëfortë në shumicën e rasteve dhe nuk i tregoni ndjenjat tuaja.



VIJGJËRËSHA

Dikush do të kërkojë sqarime nga ju sepse përse gjatë kësaj kohe nuk keni shfaqur përkushtimin e duhur. Është diçka momentale që do të sqarohet.



PESHORJA

Këtë periudhë keni zgjedhur një

mënyrë kontradiktore për të qenë në vëmendje, vetëm nëpërmjet heshtjes suaj dhe injorimit të personave të caktuar.



AKREPI

Keni bërë ç'është e mundur për t'i sqaruar gjërat me një person të caktuar, por përsëri ju kanë keqkuptuar.



SHIGJETARI

Sot mund t'ju lindin probleme me familjarët sepse nga punët e tepërta do të harroni disa ngjarje dhe situata që nuk mund të harrohen.



BRICJAPI

U keni dhënë hapësirën e duhur personave të duhur, por nuk jeni shprehur për këtë gjë. Do ta keni mirënjohjen e tyre në të ardhmen e afërt.



UJORI

Të eni përpara në karrierën tuaj në këto momente paraqitet mjaft e vështirë. Ka rrethana të caktuara që nuk ju lejojnë të bëni atë që doni.



PESHQIT

Sot doni ta ndryshoni rrugën që keni marrë për të tejkaluar një problem të caktuar. Duhet ta merrni dhe mendimin e të tjerëve.

Prezantuesi i njohur i "Sky Sports"-it lë punën për t'iu përkushtuar djalit



Prezantuesi i njohur i "Sky Sports"-it, Simon Thomas, ka njoftuar përmes "Twitter"-it se do të largohet nga puna për t'iu përkushtuar djalit të vetëm, Ethan.

Ai nuk ka ngurruar të falënderojë kompaninë që, sipas Thomasit, e ka mbështetur përtej limiteve, por tha se ndiente që duhet ta bënte këtë hap.

Rita Ora tregon se kur do të fillojë turneu



Këngëtarja e famshme me prejardhje nga Kosova, Rita Ora, ka bërë me dije se do të mbajë një turne gjatë muajit maj. "Turne i vajzave" do të quhen koncertet e Ritës, ndërsa do ta

shoqërojnë edhe disa artiste të tjera. Përmes rrjetit social "Instagram", Rita Ora ka publikuar një fotografi ku shihet e shtrirë në dysheme, pa grim dhe me flokë të lidhura lart.



Dua Lipa gëzon suksesin e radhës

Këngëtarja e famshme me prejardhje nga Kosova, Dua Lipa, ka arritur suksesin e radhës. Ajo ka shitur dy milionë albume në të gjithë botën. Lajmi është konfirmuar

nga vetë 22-vjeçarja me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram". "2 milionë albume në të gjithë botën. I dua të gjithë fansat dhe ekipin tim", ka shkruar Dua Lipa.


Amy Schumer shtrihet në spital



Amy Schumer ka anuluar një vizitë në Britani të Madhe për ta promovuar filmin e saj të ri "Feel Pretty" për shkak se u shtrua urgjentisht në spital. Aktorja ka njoftuar fansat e saj se një udhëtim i

planifikuar në Evropë gjatë javës së ardhshme do të anulohet pasi ajo po përballet me infeksion të veshkave. "Më duhet të fokusohem në shëndetin tim fillimisht", ka shkruar Schumer në rrjetet sociale.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	REAL BETIS - MALAGA	1	NURNBERG - BRAUNSCHWEIG	3+	LUBECK - HAVELSE	1
-------------------	---------------------	---	-------------------------	----	------------------	---

Çlirim Lepaja, 'Iniesta' i Kosovës


Futbolli i Kosovës të ardhmen e ka të ndritur, pasi në vazhdimësi shkollat e futbollit janë duke prodhuar talente. I tillë është edhe rasti i Çlirim Lepajës, që shumë shpejt pritet të bëhet pjesë e ekipit të parë në KF Trepça '89 dhe e Përfaqësues së Kosovës U19. Futbollisti 17-vjeçar ka thënë për "Epokën e re" se të ardhmen e sheh vetëm në futbollin evropian

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 PRILL - Futbollisti Çlirim Lepaja me talentin që ka dhe me paraqitjet që po bën me skuadrën e Trepçës '89 mund të vlerësohet si "Iniesta" i futbollit të Kosovës. Çlirimi nga lojtarët vendorë e pëlqen ish-lojtarin e Trepçës '89, Florent Hasanin, kurse nga lojtarët ndërkombëtarë e pëlqen Andreas Iniesten. Djaloshi nga Prishtina i ka rënë në sy ekipit të gazetës "Epoka e re" në grumbullimin që kishite në Përfaqësuesen e Kosovës U19 gjatë javës së kaluar. Gazeta e ka kontaktuar të dielën futbollistin

në fjalë, i cili ka treguar se si i lindi dashuria që të merret me futboll. "Lojën e futbollit e kam adhuruar që nga fëmijëria. Çdo ditë luaja me fëmijët e lagjes, më pas u aktivizova në skuadrën e 2 Korrikut. Që nga atëherë për asnjë moment nuk iu kam ndarë kësaj loje. Angazhimin në 2 Korrik e kam bërë në moshën pesëvjeçare. Fillimisht trajner ka qenë Rufki Ballazhi, më pas kam punuar me trajnerët Mustaf Pronaj dhe Besim Ademi", ka treguar Lepaja, i cili, pas e ka fituar një përvojë në këtë skuadër, ka rënë në sytë e trajnerëve të Trepçës '89 të cilët ishin këmbëngulës që ai t'i bashkohet klubit nga Mitrovica. "Në

skuadrën e 2 Korrikut kam qëndruar rreth gjatë vjet. Kam pasur kontakte me skuadrën e Trepçës '89 dhe ka qenë këmbëngulëse për kalimin tim aty dhe më ofruan kushte më të mira", ka shtuar ai. "2 Korriku është një klub shumë i mirë. Trajnerët bëjnë punë të mirë, çka e dëshmon fakti se shumë lojtarë kanë dalë nga kjo shkollë, por edhe do të dalin edhe në vitet e ardhshme", ka thënë Lepaja. Futbollisti 17-vjeçar është pjesë e juniorëve, por ka qenë i ftuar edhe në ekipin e parë të Trepçës '89 gjatë fazës përgatitore. "Jam pjesë e ekipit të juniorëve, por klubi më ka grumbulluar në



ekipin e parë ku mund të them lirisht se kam lënë përshtypje të mira. Në atë kohë ka qenë trajner Zekrija Ramadani, i cili, së bashku me trajnerët e tjerë, më kanë dhënë lëvdata dhe më kanë këshilluar ta vazhdoj punën për të

dalë në ekipin e parë", ka deklaruar ai.

Më pas Çlirim Lepaja ka treguar edhe për grumbullimin në përfaqësuesen që drejtohet nga Ramiz Krasniqi: "Jam shumë i kënaqur që kam qenë pjesë e selektimit dhe grumbullimit të kombëtares. Ishte një përvojë e mirë. Besoj se kam treguar se e meritoj të jam pjesë edhe në grumbullimet e tjera". Mesfushori Çlirim Lepaja synon që një ditë të bëhet pjesë e ndonjë klubi të madh evropian. "Në kampionatin e ardhshëm pres të kaloj në ekipin e parë. Mendoj se kam potencial dhe me punën që e kam bërë dhe po e bëj, nuk besoj se do ta kem problem kalimin në ekipin e parë. Ndërsa synimi im është të luajë sa më shumë në ekipin e seniorëve, më pas të kaloj te një klub i madh evropian", ka përfunduar Lepaja.

Drita dhe Prishtina nuk gabojnë, vazhdon gara për titull

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 PRILL - Vendësit shënuan fitore në katër ndeshje të Vala Superligës së Kosovës në Futboll, kurse dy ndeshje përfunduan baras. Gara për titull vazhdon të zhvillohet në mes të Dritës dhe Prishtinës që shënuan fitore ndaj Feronikelit, përkatësisht Llapit. Garë e nxehtë po zhvillohet edhe për pozitën e barazhit, ku Flamurtari dhe Besa ndajnë këtë pozitë me pikë të barabarta.



Drita - Feronikeli, 3-1

Skuadra e Dritës së Gjilanit vazhdon ta mbajë kryesimin në elitë, pasi të dielën e mposhti në Gjilan, Feronikelin (3-1). Ishte skuadra nga Drenasi që shënoi e para nëpërmjet Mendurim Hotit (30), por vendësit barazuan në pjesën e dytë nëpërmjet Bujar Shabanit (62). Më pas rast të mirë për vendësit lëshoi Kastriot Rexha, kurse për mysafirët Granit Arifaj. Një minutë pa përfunduar koha e regullt e ndeshjes, Ahmet Haliti luajti me dorë në zonën e rreptësisë dhe gjyqtari kryesor akordoi penallti dhe gol shënoi Fidan Gërbeshi. Në minutat shtesë rezultatin final 3-1 e vulosi Leutrim Kryeziu.

Prishtinë-Llapi, 3-1

Fitore ka shënuar edhe Prishtina, e cila nuk e ka ndër mend të heqë dorë nga gara për titull, duke i qëndruar në tri pikë prapa Dritës. Kryeqytetasit e mposhtën Llapin në Pejë me rezultat 3-2. Ish-reprezentuesi i Shqipërisë, Ahmed Januzi, në minutën e parë e solli Prishtinën në epërsi 1-0. Pesë minuta më vonë Mentor Zhdrella e barazoi rezultatin 1-1. Arbër Hoxha (21) e riktheu epërsinë e Prishtinës (2-1), kurse Januzi e shënoi edhe golin e dytë dhe të tretin personal në fund të pjesës së parë. Dy minuta para fundit Altin Merlaku realizoi për 3-2. Në xhiron e radhës Prishtina i shkon Feronikelit, kurse Llapi e pret Drenicën.

Vëllaznimi-Besa, 0-0

Dikur një prej ndeshjeve më interesante në futbollin e Kosovës, Vëllaznimi-Besa, të dielën nuk zgjoi interesim aq të madh, kurse nuk solli as fitues, pasi përfundoi 0-0. Besa vazhdon të jetë e parafundit me pikë të barabarta me Flamurtarin, duke synuar pozitën e barazhit, kurse Vëllaznimi nuk ka shumë ambicie në kampionat, sepse mbijetesën e ka siguruar dhe është i fokusuar plotësisht në garën e Kupës ku në finale luan ndaj Prishtinës.

Trepça '89-Flamurtari, 0-0

Edhe ndeshja në mes të Trepçës '89 dhe Flamurtarit përfundoi 0-0. Kampionia e Kosovës e pati më

shumë dominimin në këtë ndeshje, por gola të shënuara nuk pati. 89-shi e ka humbur hapin për titull, kurse Flamurtari është i dhjeti, pozitë nëpër të cilën synon ta sigurojë mbetjen në elitën e futbollit të Kosovës.

Fitojnë Liria dhe Drenica

Liria ka shënuar fitore para tifozëve të vet në stadiumin "Përparim Thaçi" në Prizren në duel me Gjilanin, me rezultat 3-2. Vendësit kaluan në epërsi në minutën e nëntë me golin e shënuar nga Elton Basri. Rezultati u barazua në minutën e 36 me golin e Ylber Kastarit, por pak para përfundimit të pjesës së parë Artur Magani e riktheu epërsinë për Lirinë, 2-1. I njëjti futbollist shënoi edhe në minutën e 64-t për 3-1. Mysafirët arritën ta ngushtojnë epërsinë e vendësve në minutën e 74-t me golin e Betim Haxhimusës (3-2). Efikasitet edhe më i madh u tregua në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj, ku Drenica e mposhti Vllazninë 6-2. Dy gola i realizoi Denis Peposhi (30', 65'), derisa me nga një gol kontribuan Hysen Tahiri (52'), Dukagjin Gashi (58'), Drilon Osmani (72') dhe Genc Hamiti (85'). Në anën tjetër golat për mysafirët nga Pozherani i shënuan Ardian Terziu (76') dhe Almedin Murati (87').

VALA SUPERLIGA

Trepça '89-Flamurtari	0-0
Drita-Feronikeli	3-1
Prishtina-Llapi	3-2
Vëllaznimi-Besa	0-0
Liria-Gjilani	3-2
Drenica-Vllaznia e Pozharanit	6-2

TABELA

1. Drita	59 pikë
2. Prishtina	56
3. Liria	47
4. Llapi	45
5. Drenica	45
6. Trepça '89	44
7. Gjilani	43
8. Feronikeli	42
9. Vëllaznimi	36
10. Flamurtari	19
11. Besa	19
12. Vllaznia	14

Në xhiron e radhës takohen: Liria-Trepça '89, Gjilani-Drita, Feronikeli-Prishtina, Llapi-Drenica, Vllaznia (P)-Vëllaznimi, Besa-Flamurtari.

LIGA E PARË

Dukagjini-Ballkani	1-2
Vushtrria-Kika	4-1
Trepça-KEK-u	1-2
Vitja-Ramiz Sadiku	2-0
Ferizaj-Kosova (P)	3-0
Fushë Kosova-Bashkimi (K)	2-0
2 Korriku-Hajvalia	2-0
Onix-Rahoveci	2-0

TABELA

1. Ballkani	60 pikë
2. KEK-u	59
3. Vushtrria	56
4. Ferizaj	50
5. Onix	44
6. Fushë-Kosova	44
7. Vitja	35
8. Bashkimi (K)	33
9. 2 Korriku	33
10. Dukagjini	32
11. Ramiz Sadiku	32
12. Trepça	32
13. Rahoveci	27
14. Kika	27
15. Hajvalia	26
16. Kosova (P)	8

Kuka: Evropian i suksesshëm

PRISHTINË, 29 PRILL - Xhudistet e Kosovës kanë shkëlqyer në Kampionatin Evropian të Xhudos i cili u mbajt në Tel Aviv të Izraelit. Nora Gjakova e fitoi të artën pasi u shpall kampione evropiane, derisa Distria Krasniqi e fitoi të argjendtën, respektivisht u shpall nënkam-

pione evropiane. Për këto suksese dhe për dy pozitat e shtata, të Akil Gjakovës dhe të Lorian Kukës, trajneri Driton Kuka ndihet mjaft i kënaqur, duke e konsideruar këtë si Evropianin më të suksesshëm ndonjëherë për Kosovën. "Kosova me dy medalje e me

dy vende të shtata arrin suksesin më të madh si ekip në ndonjë evropian deri më tash, edhe me mungesën e kampioneve sonë olimpikë. Krenar me paraqitjen e secilit veç e veç. E bekuar qoftë çdo sekondë e kaluar duke punuar me ju. Kosova do të mbetet në Top 5

të renditjes në një Kampionat Evropian, që është një plasman historik, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e punës sonë. Ju përshëndet ekipi i vogël, por me zemër e punë të madhe", ka shkruar Kuka.



Hamiltoni triumfon në Australi

BAKU, 29 PRILL - Lewis Hamiltoni me Mercedes fitoi garën e Çmimit të Madh të Azerbajxhanit, gara e 4-t sezonale e Botërorit të Formulës 1. Ky është suksesi i parë sezonal për pilotin britanik që la pas Kimi Raikkonenin (i dyti me Ferrarin) dhe Sergio Perezin (i treti me Force India), që u ngjiten në podium.

Një fund i çmendur i garës zhvilluar në pistën qytetase të Bakus i dha fitoren Hamiltonit, që nuk e priste këtë sukses. Dalja e makinës së sigurisë 4 xhiro nga fundi, që fillimisht përfitoi nga një parakalim i gabuar i Vettelit, që doli jashtë piste dhe më pas nga dëmtimi i gomës së Bottas për ta fituar garën.

Verstappen e Ricciardo bëhen protagonistë dhe ajo që u evitua deri në ato momente nuk mundi të shmangte 11 xhiro nga fundi, kur dy makinat Red Bull përplasen dhe mbyllin garën.



Australiani godet nga pas shokun e skuadrës, ndërkohë që në pistë hyn sërish makina e sigurisë. Të gjithë pilotët hyjnë në bokse dhe ndërrojnë gomat, por nga kjo situatë përfitoi Bottas, që nuk i kishte ndërruar gomat deri në ato momente. Edhe Grosjean pëson aksident nën regjimin e makinës

së sigurisë, që shtyn qëndrimin e saj në pistë deri 4 xhiro nga fundi, kur nis spektakli i madh. Hamiltoni korr suksesin e parë në Baku dhe merr kreun e renditjes, ndërsa Velteli bën një manovër të gabuar, pasi i mjaftonte të priste një xhiro dhe do të fitonte.

Bostoni në gjysmëfinale, Golden State 'leksion' New Orleansit

BOSTON, 29 PRILL - Bostoni është skuadra e tretë gjysmëfinaliste e "play-off"-it në Konferencën e Lindjes, pas fitores 112-96 ndaj Milwaukee në çerekfinalen e shtatë. Një ndeshje e dominuar nga basketbollistët e Celticsit që patën epërsi gjatë gjithë kohës, duke u shkëputur që në pjesën e parë. Horfordi dhe Rozieri realizuan nga 26 pikë secili, duke bërë diferencën në parket, mbështetur edhe nga Tatum me 20, duke bërë që të mos ndihet mungesa e Irvingut. Për Milwaukee u dallua Middletoni me 32 pikë, por që mbetet për statistikë. Ndërkohë që në Lindje luhen ende ndeshjet çerekfinale, në Konferencën e Perëndimit kanë nisur takimet gjysmëfinale dhe sot ekipi kampion i Golden States mposhti me lehtësi 123-101 rivalët e New Orleansit në përballjen e pare. Një ndeshje që ishte një formalitet për skuadrën e Warriorsit, që u shkëput mbi 30 pikë, duke dominuar në çdo moment. Sërish nuk u aktivizua Curry, ndërkohë që



më të mirët në parket ishin Thompsoni me 27 pikë e Duranti me 26 pikë e 13

rebounde (Green realizoi një triple double, 16 pikë, 15 rebounde e 11 asistime).

KONFERENCA E LINDJES - ÇEREKFINALE

1-8 Toronto - Washington	(4-2 me ndeshje)
2-7 Boston - Milwaukee	112-96 (4-3 me ndeshje)
3-6 Philadelphia - Miami	(4-1 me ndeshje)
4-5 Cleveland - Indiana	(3-3 me ndeshje)

KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE

Houston - Utah Jazz	
Golden State - New Orleans	123-101 (1-0 me ndeshje)

SHKURT

Prishtina e fitoi derbin në Ferizaj

Skuadrat mysafire kanë shënuar fitore në ndeshjet e javës së 27 të Superligës A për meshkuj në hendboll. Derbin e xhiros në mes të Kastriotit dhe Prishtinës e fitoi skuadra nga kryeqyteti me rezultat 33:31. Pas pjesës së parë epërsia në të mirë të Prishtinës ishte pesë gola, 19:14. Besa FamGas fitoi bindshëm ndaj Dritës në Gjilan me rezultatin 39:20. Në Gjilan u luajt edhe ndeshja Zhegra-Vëllaznimi që u mbyll me fitoren e gjakovarëve me 38:31. Besa është e para me 52 pikë. Prishtina renditet e dyta me 48, ndërsa Kastrioti mbanë vendin e tretë me 30 pikë. Drita e vendit të katërt i ka 28 pikë. Këto katër skuadra do të luajnë në "play-off". Jashtë "play-off"-it do të mbesin Vëllaznimi që në vendin e pestë i ka 21 pikë dhe Zhegra e vendit të gjashtë. Zhegra i ka 19 pikë.

Napoli i ofron kontratë të re Hysajt

Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Elseid Hysaj, shikohet si një nga mbrojtësit më të ardhmen më të ndritur të futbollit evropian. Pas tij janë vënë shumë ekipe me emër. Ekipi i fundit që u raportua së fundmi se kërkon shërbimet e Hysajt është Chelsea e Antonio Contes. 24-vjeçari ka marrë nga ekipi i tij, Napoli, një ofertë me një kontratë e cila skadon në 2023-n. Në kontratë parashikohet një rritje rroge nga 1.5 milion euro në sezon në 2.5. Sipas medieve italiane, shqiptari ka një klauzolë që e liron nga Napoli prej 55 milionë eurosh. Shumë klube në Evropë janë të gatshme ta paguajnë këtë shumë për anësin e djathtë.

Ancelotti refuzon Italinë, shkak një klub anglez

Carlo Ancelotti nuk do të jetë trajneri i ri i kombëtares italiane të futbollit. Ish-trajneri i Milanit, aktualisht me pushime në Kanada, u ka bërë me dije drejtuesve të Federatës Italiane të Futbollit (FIGC) se e refuzon ofertën që i është bërë. Sipas medieve sportive italiane, Ancelotti ka arritur një marrëveshje me një klub të huaj, ku mendohet se ka qenë edhe më parë trajner. Logjika të çon vetëm të Chelsea. Tashmë, për Italinë mundësia e vetme mbetet Roberto Mançini, ish-trajneri i Interit dhe Manchester Cityt.

Monaco e kërkon Luizin

David Luizi do të largohet nga Chelsea. Interesim për mbrojtësin brazilian ka shprehur një klub i madh nga Liga 1, përcjellë "Lajmi.net". Bëhet fjalë për Monacon, raporton "Goal". Klubi bardhekuq pritet ta dërgojë shumë shpejt ofertën zyrtare në drejtim të Chelseat për lojtarin.

Matthaus: Reali nuk është i interesuar për Lewandowskin

Ish-ylli i Bayern Munchen dhe Gjermanisë, Lothar Matthaus, ka theksuar se gjiganti spanjoll nuk dëshiron ta transferojë sulmuesin polak Lewandowski, 29-vjeçar, është lidhur ngushtë me një kalin në kryeqytetin spanjoll pas katër sezoneve shumë frytdhënëse në Bayern, përfshirë 39 gola në të gjitha garat këtë sezon. "Sipas informatave që kam, Real Madridi nuk është i interesuar për Lewandowskin", ka thënë Matthaus.

Sane në "radar" të Realit

Real Madridi do të bëjë disa ndryshime në skuadër për sezonin e ardhshëm dhe reparti më i prekur do të jetë sulmi. Mësohet se trajneri Zinedine Zidane i ka kërkuar presidentit Florentino Perez 2-3 goditje dhe një prej tyre është Leroy Sane, i cili ka kontratë deri në vitin 2021 me Manchester Cityn. Nuk do të jetë e lehtë për madriënët që ta rëmbejnë talentin gjerman nga Pep Guardiola, por ata shpresojnë se me një ofertë prej 80-90 milionë eurosh t'i bindin sheikët e "Citizens"-it për ta lënë të lirë 22-vjeçarin.



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Universiteti Publik "Kadri Zeka", më datë 30.04.2018, bënë:

Shpallje të Konkursit Publik - Marrëveshje për Shërbime të Vecanta

Titulli i pozitës: Zyrtar i Prokurimit
Niveli i pagës: Sipas Rregullores për të AP të UKZ-së
Raporton te: Sekretari i Përgjithshëm
Lloji i kontratës: Marrëveshje për Shërbime të Vecanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj
Orari i punës: 1 plotë
Numri i ekzekutuesve: 1 ekzekutues
Lokacioni: Gjilan

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Analizon aktivitetet aktuale të prokurimit dhe rekomandon përmirësimin përmes metodave më efikase të prokurimit dhe standardizimit të procedurave të prokurimit si dhe merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e dokumenteve të prokurimit;
- Përgatit dokumentacionin dhe ftesa për oferta për tenderë dhe dërgimin e tyre për shpallje në mjetet e informimit si dhe regjistron të gjithë kompanitë që marrin materialin e tenderit;
